


# Kalendari i Aktiviteteve Shkencore dhe Akademike

AMEA



# 2019 ANNUAL REPORT



**Spitali Amerikan - Revolucion në teknologji moderne dhe inovacionet bashkëkohore në shërbimin shëndetësor**

Kjo është një kohë e veçantë në historinë e kompanisë sonë, ndërsa festojmë 15 vjetorin e krijimit të Spitalit Amerikan. Udhëtimin tonë e filluam në vitin 2006, dhe kemi kaluar dekadën duke vazhduar ndërtimin e markës sonë, e cila tashmë është bërë sinonim i ofrimit të shërbimit më cilësor të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, rajon e më gjerë.



Duke parë përpara, jemi të përqëndruar në strategjinë e rritjes dhe forcimit të strukturës, por dhe ofrimin e një kujdesi sa të mirë mjekësor, duke sjellë ndryshime pozitive në komunitetet në të cilat punojmë dhe jetojmë.

Unë ju jam mirënjohës për këtë udhëtim dhe, me të vërtetë besoj se më e mira nuk ka ardhur ende.


Në rrugën e përmirësimit të vazhdueshëm për të arritur sukses është e rëndësishme që të vazhdojmë të plotësojmë nevojat e kujdesit shëndetësor të komunitetit tonë, të sjellim teste bashkëkohore, aparatura moderne diagnostikuese, një gamë të gjerë shërbimesh, teknologji inovative dhe të promovojmë standarde më të mira të kujdesit. Qëllimi ynë është të gjejmë mënyra sa më të mira për ta bërë kujdesin shëndetësor më të përballueshëm dhe më të arritshëm për njerëzit që u besojnë jetën duarve të profesionistëve tanë.

Suksesi i arritur i atribuohet drejtpërdrejt më shumë se 2200 profesionistëve të shëndetësisë: mjekë të talentuar, infermierë të aftë dhe stafit të përkushtuar organizativ të Spitalit Amerikan. Duke ecur përpara së bashku, është përgjegjësia jonë për të zgjeruar dhe shkëmbyer njohuritë midis ekspertëve mjekësorë dhe po e bëjmë këtë jo vetëm në nivel kombëtar por edhe ndërkombëtar për të qenë koherentë me arritjet e fundit të jashtëzakonshme në fushën e Mjekësisë dhe tendencat e nevojat e së ardhmes.

Platforma e Edukimit në Vazhdim të strukturës ofron mundësi për të përshfaqur zhvillime të reja të rëndësishme, përparimet shkencore në mjekësinë moderne, aritjet e bëra për të shkëmbyer eksperiencë, diskutuar raste dhe risi, për të qenë interaktiv në disiplinat e kujdesit mjekësor dhe performancës klinike.

Jam i sigurt, se secili nga ju do të gjejë veten në aktivitetet tona shkencore, ku risitë dhe të rejat më të fundit të mjekësisë do të diskutohen në to, pasi Edukimi i Vazhdueshëm është pasaporta jonë për të ardhmen!

*Me respekt!*  
*Klodian Allajbeu*  
*CEO – Spitali Amerikan*



**“Wherever the art of  
medicine is loved, there is  
also a love of humanity”  
- Hippocrates**

## Rëndësia e Edukimit të Vazhdueshëm në Mjekësi

Zhvillimi i vazhdueshëm i mjekësisë, risitë teknologjike dhe hulumtimet shkencore mjekësore nënkuptojnë që profesionistët e shëndetësisë duhet vazhdimisht të kenë njohuri mbi të rejtat e fundit në mjekësi.

Një "Edukim i Vazhdueshëm" është thelbësor për t'u garantuar pacientëve një shërbim sa më të cilësor dhe një mjekim sa më të përshtatshëm. Ai përqendrohet në ruajtjen, zhvillimin e njohurive, aftësive dhe marrëdhënieve për të siguruar praktikë profesionale bashkëkohore dhe kompetente me fokus drejt përsosmërisë së kujdesit ndaj pacientit.

Duke qenë se në Spitalin Amerikan parimi kryesor është **"Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në kujdesin shëndetësor dhe sigurinë e pacientit"**, që nga viti 2015 ky spital ofron për gjithë mjekët dhe stafin infermieror, laborantët, teknikentët, aktivitete të shumta shkencore si: kongrese, konferenca, uorkshope, simpoziume, seminare, leksione, trajnime etj., në çdo disiplinë të mjekësisë.

Kjo bën që të gjithë profesionistët e shëndetësisë të rinovojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre që të jenë në gjendje t'i përgjigjen në mënyrë sa më adekuate nevojave të pacientëve, duke ofruar një shërbim cilësor dhe kompetent. Ndryshimet e vazhdueshme në fushën e mjekësisë përfshijnë rritjen e inovacionit në modalitetet terapeutike dhe diagnostikuese, rritjen e bashkëpunimit ndër specialitet dhe shndërrimin e specialiteteve tradicionale jo ndërhyrëse në disiplina ndërhyrëse.

Edukimi në vazhdim është zhvendosur nga përmirësimi i njohurive në përmirësimin e aftësive dhe performancës ndaj pacientit dhe e që të garantojë sukses, duhet të jetë vërtet i vazhdueshëm dhe jo rastësor. Përgjatë këtyre viteve kemi zhvilluar 4 Kongrese Ndërkombëtare Multidisiplinore Mjekësore me mbi 2000 pjesëmarrës nga vendi dhe bota, 19 Konferenca mjekësore, 15 Seminare dhe Leksione infermiore, Uorkshope, Simpoziume dhe trajnime të ndryshme për stafet mjekësore. Por, gjithashtu, Spitali Amerikan ka në qendër të vëmendjes jo vetëm kurimin e pacientëve, por dhe rritjen e kulturës shëndetësore në popullatë përmes trajnimeve, promovimeve dhe takimeve sensibilizuese, ndërgjegjësuese dhe informuese, duke përfshirë dhe të rinjtë e shkollave të mesme në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit kundër patologjive të ndryshme, sidomos atyre onkologjike.

Këto aktivitete shkencore janë padyshim eventet më prestigjioze të mjekësisë moderne bashkëkohore, që përshfaqin nivel të lartë akademik e shkencor e përfaqësohen denjësisht nga elita mjekësore e 30 shteteve të botës si USA, Evropa, Azia, Ballkani, si edhe nga mjekët e trevave mbarë shqiptare. Synimi i tyre është rritja e profesionalizmit së armatës mjekësore jo vetëm të Spitalit Amerikan dhe Hygeia, por edhe më gjerë. Pjesëmarrja i kalon kufijtë e vendit tonë, duke u bërë një qendër reference ku mjekët takohen dhe marrin të rejtat e fundit në disiplina të ndryshme dhe akreditohen nga instituti më prestigjioz në vend

### **Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë.**

Është detyrë e çdo profesionisti të mjekësisë të marrë edukim të vazhdueshëm dhe pa këtë edukim shkencor do të ishte e pamundur që t'u përgjigjet nevojave të pacientëve në mënyrë sa më profesionale, kompetente dhe efektive. Prandaj, Spitali Amerikan duke qenë pararojë në këtë drejtim, ofron mundësi të ndryshme në disiplina të ndryshme.

Gjithashtu, për të dytin vit radhazi për studentët e Fakultetit të Mjekësisë, Spitali Amerikan dhe Hygeia do të ofrojnë **3 (tre)** Bursa për studentët ekselentë deri në përfundim të Fakultetit. Këtë herë këto bursa do t'u ofrohen edhe studentëve ekselentë të trevave mbarë shqiptare nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Çdo vit Drejtoria e Strategjisë Akademike dhe Edukimit Mjekësor vjen me një kalendar të mirë përcaktuar dhe së fundmi me Kalendarin e Aktiviteteve Shkencore për Vitin Akademik 2020.

Arritjet e sipërpërmendura, natyrisht janë investim madhor i drejtuesve të strukturës dhe punë kolosale e një grupi të përkushtuar profesionistësh të shëndetësisë, kolegë dhe staf administrativ, që pa bashkëpunimin e secilit këto evente shkencore shumë cilësore nuk do të ishin realizuar!

*Mirënjohje pa fund për secilin prej tyre!  
Spitali Amerikan, kontribut për dijen dhe shkencën!*

**Dr. Shk. Lindita Shosha Mano**  
Drejtore e Strategjisë Akademike  
dhe Edukimit Mjekësor  
Spitali Amerikan



# KALENDARI I AKTIVITETEVE SHKENCORE DHE AKADEMIKE **2019**

2019/ MUAJI	DEPARTAMENTI MJEKËSOR ORGANIZUES KONFERENCA/SEMINARE	MJEK – KORDINATOR
28 SHKURT	<b>Konferenca e Oftalmologjisë</b> Fokus: "Kirurgjia mini-invazive në Oftalmologji"	<i>Teuta Havieri</i>
25 SHKURT	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Zbatimi korrekt i teknikave infermiore në parandalimin e infeksioneve spitalore si mjet për rritjen e sigurisë së pacientëve në spitale"	<i>Edlira Cako</i>
28 MARS	<b>Konferenca e Nefrologji-Kirurgji vaskulare</b> Fokus: "Terapia renale zëvendësuese, sfidat për të ardhmen"	<i>Fiona Nasto-Bledar Hodo</i>
21 MARS	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Roli i infermierëve në menaxhimin dhe edukimin e pacientëve me sëmundje kronike të veshkave"	<i>Anduela Zeka</i>
25 PRILL	<b>Konferenca e Neurologjisë</b> Fokus: "STROKU, faktorët e riskut dhe sfidat e trajtimit të tij"	<i>Zamir Ndroqi</i>
18 PRILL	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Menaxhimi i pacientit pas kirurgjive të mëdha abdominale, një sfidë për pacientin dhe stafin"	<i>Esmeralda Rapo</i>
30 MAJ	<b>Konferenca e Kardiologjisë</b> Fokus: "Emergjencia kardiake, diagnoza dhe trajtimi optimal i tyre"	<i>Nereida Xhabija</i>
23 MAJ	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Ndikimi i sëmundjeve kardiake në cilësinë e jetës së pacientëve"	<i>Anida Zalla</i>
27 QERSHOR	<b>Konferenca e Endokrinologjisë</b> Fokus: "Diabeti 2019: Risitë e fundit në trajtimin e tij"	<i>Entela Puca</i>
20 QERSHOR	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Komplikacionet e hershme dhe të vona që sjellin çrregullimet endokrine kronike në organizmin e njeriut"	<i>Jonida Vrenozaj</i>
25 KORRIK	<b>Konferenca e Hematologji-Histopatologjisë</b> Fokus: "Trajtimi i Mielomës Multiple, kontroll kundrejt shërimit. Transplanti i qelizave burimore Hematopoietike, realitet i ri trajtimi në Shqipëri"	<i>Sotiraj Lako-Leart Berdica</i>
18 KORRIK	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Siguria e pacientit në sallën operatore, menaxhimi infermieror"	<i>Edlira Cako-Arjeta Deda</i>
26 SHTATOR	<b>Konferenca e Onkologjisë</b> Fokus: " Roli i MDT në trajtimin e kancerit"	<i>Emiljana Huti</i>
19 SHTATOR	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Kujdesi infermieror në pacientët e hospitalizuar në njësitë e Kujdesit Intensiv në stadet e fundit të jetës"	<i>Elona Areza-Eugen Ismulli</i>
24 TETOR	<b>Konferenca e Infektivit</b> Fokus "Gripi, parandalimi, ecuria klinike dhe ndërlikimet e mundshme të tij"	<i>Tritan Kalo</i>
17 TETOR	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Sëmundja malinje, menaxhimi infermieror i impaktit fizik dhe psikologjik që shkakton tek pacienti"	<i>Ardita Plaku</i>
23 NËNTOR	<b>MASTERKLAS</b> Fokus : "Trendet aktuale në Kirurgjinë Kolorektale mini-invazive"	<i>Lindita Shosha Mano</i>
19 DHJETOR	<b>Konferenca e Pediatri-Neonatologjisë</b> Fokus: "Debatet dhe kujdesi primar në përditshmërinë e Pediatriisë klinike"	<i>Niketa Koliqi</i>
12 DHJETOR	<b>Seminar infermieror</b> Fokus: "Kujdesi infermieror për nënën dhe fëmijën gjatë dhe pas lindjes së komplikuar"	<i>Brunilda Qose</i>

## KOMITETI ORGANIZUES

**Klodian Allajbeu**  
Drejtor i Përgjithshëm  
Spitali Amerikan

**Lindita Shosha**  
Drejtoreshë e Strategjisë Akadematike  
dhe Edukimit Mjekësor

**Mario Karaj**  
Drejtor i Menaxhimit Spitalor  
Spitali Amerikan

**Onejda Ymeraj**  
Drejtoreshë Operacionale  
Spitali Amerikan

## SEKRETARE ORGANIZATIVE

**Albana Mehmeti**  
Kordinatore e Edukimit në Vazhdim

Email: [albana.mehmeti@spitaliamerikan.com](mailto:albana.mehmeti@spitaliamerikan.com)

Web: [www.imca.al](http://www.imca.al)

Mob: 0684032151

**Bordi Editorial AMEA 2019**



**Lindita Shosha Mano**



**Nereida Xhabija**



**Teuta Haveri**



**Entela Puca**



**Edlira Cako**



**Sotiraq Lako**



**Fiona Nasto**



**Emiljana Huti**



**Bledar Hodo**



**Tritan Kalo**



**Zamir Ndroqi**



**Niketa Koliqi**

# KONFERENCA MJEKËSORE E OFTALMOLOGJISË

Organizuar nga Departamenti i Okulistikës së Spitalit Amerikan

**Fokus: "Kirurgjia mini-invazive në Oftalmologji"**

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 Shkurt 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Teuta Haveri



Dr. Mimoza Meço



Dr. Leart Bërdica



Dr. Alketa Tandili



Dr. Alfred Aga



Dr. Marjeta Bilaj



Prof. Dr. Ugo De Sanctis

## PROGRAMI SHKENCOR:

Moderatore: Dr. Teuta Haveri

**15:00-15:25**

**Teknika mini-invazive Cross-linking në trajtimin e keratokonusit.**

Dr. Teuta Haveri, Shefe e Departamentit të Okulistikës, Spitali Amerikan.

**15:25-15:50**

**Teknikat mikro-invazive në kirurgjinë e Glaukomës (MIGS).**

Dr. Mimoza Meço, Spitali Amerikan

**15:50-16:15**

**Kirurgjia endoskopike e orbitës dhe rrugëve lakrimale.**

Dr. Alfred Aga, Shef i Departamentit të Kirurgjisë Onkologjike të kokës dhe të qafës, Spitali Amerikan.

**16:15-16:40**

**Aplikimet e membranave amniotike në Oftalmologji.**

Dr. Leart Bërdica, Shef i Departamentit të Anatomisë Patologjike, Spitali Amerikan dhe mjek në Shërbimin e Anatomisë Patologjike QSUT.

**16:40-17:05**

**Kirurgjia e muskulit oblik inferior.**

Dr. Alketa Tandili, QSUT

**17:05-17:30**

**Teknikat e anestezisë në kirurgjinë mini-invazive në Oftalmologji.**

Dr. Marjeta Bilaj (Miraka), Spitali Amerikan

**17:30-17:50**

**Transplanti shtresor i kornesë, një teknikë minimalisht invazive e transplantit.**

Dr. Ugo de Sanctis, Spitali Amerikan

**17:50-18:00**

**Diskutime, Konkluzione**

Kategoria e pjesëmarrësve: mjekë klinikistë, okulistë, patologë, kirurgë, anestezistë, farmacistë, infermierë etj.

## KOMITETI ORGANIZUES

**Klodian Allajbeu**

Drejtor i Përgjithshëm  
Spitali Amerikan

**Lindita Shosha**

Drejtoresh e Strategjisë Akademike  
dhe Edukimit Mjekësor

**Mario Karaj**

Drejtor i Menaxhimit Spitalor  
Spitali Amerikan

**Onejda Ymeraj**

Drejtoresh Operacionale  
Spitali Amerikan

## Sekretare Organizative

**Albana Mehmeti**

Koordinatorë e Edukimit në Vazhdim

Email: [albana.mehmeti@spitaliamerikan.com](mailto:albana.mehmeti@spitaliamerikan.com)

Web: [www.imca.al](http://www.imca.al)

Mob: 0684032151





Dr. Teuta Haveri



KONFERENCA MJEKËSORE  
E OFTALMOLOGJISË

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 SHKURT 2019 | 15:00 - 18:00



Prof. Dr. Ugo de Sanctis



KONFERENCA MJEKËSORE  
E OFTALMOLOGJISË

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 SHKURT 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Alfred Ajo



KONFERENCA MJEKËSORE  
E OFTALMOLOGJISË

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 SHKURT 2019 | 15:00 - 18:00




Dr. Mimosa Meço



KONFERENCA MJEKËSORE  
E OFTALMOLOGJISË

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 SHKURT 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Shkëlqim Leart Bërdica



KONFERENCA MJEKËSORE  
E OFTALMOLOGJISË

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 SHKURT 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Marjeta Bëaj (Mirakla)



KONFERENCA MJEKËSORE  
E OFTALMOLOGJISË

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 SHKURT 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Shkëlqim Alketa Tandili



KONFERENCA MJEKËSORE  
E OFTALMOLOGJISË

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 SHKURT 2019 | 15:00 - 18:00

## PO 01 Kirurgjia endoskopike e orbitës dhe rrugëve lakrimale

*Aga A.*

**Hyrje:** Kirurgjia endoskopike naso-sinusale duke filluar nga vitet 90 gjithmonë e më tepër po aplikohet në fusha të ndryshme duke e rritur gamën e indikacioneve. Këtë gjë e vërtetojnë edhe publikimet e shumta që tregojnë vlefshmërinë e kësaj teknike jo vetëm për hundën dhe sinuset paranasale për të cilat u zhvilluan, por edhe për organet përreth këtyre strukturave anatomike si: baza kraniale anteriore, e mesme dhe posteriore, fosa pterigomashelare dhe infratemporale, orbita etj.

Vitet e fundit gjithmonë e më tepër interes po merr trajtimi i patologjive të orbitës dhe të rrugëve lakrimale me anë të kësaj kirurgjie.

**Metoda:** Në këtë punim paraqitet eksperiencia e Spitalin Amerikan në përdorimin e kësaj teknike mikro-invasive. Janë gjithsej 40 raste që nga viti 2013. Në 35 raste është kryer dakriocstorinostomi endoskopike për bllokim të rrugëve lakrimale. Në 3 raste është bërë dekomprimim i orbitës nga muri medial dhe është kryer marrja e biopsisë intrakonale për leziona të dyshimta (1 rast mukormikoze, 1 rast hemangiome dhe 1 rast pseudotumor infamatore) dhe në 2 raste është bërë dekomprimi i orbitës dhe heqje e dhjamit (1 medial dhe 1 lateral) për esoftalmus dhe strabisem nga Basedow.

**Rezultati:** Në të gjitha rastet trajtimi ka rezultuar i suksesshëm pa asnjë komplikacion për pacientin dhe me kohë qëndrimi spitalor shumë të reduktuar.

## PO 02 Kirurgjia e Muskulit Oblik Inferior

*Tandili A.*

**Hyrje:** Veprimi i ekzagjeruar i muskulit Oblik Intern shkakton një ndër llojet e zakonshëm të strabizmit, me pasojë të dukshme ngritjen lart të globit okular, kur syri është në aduksion (kur shikon brenda). Incidenca e kësaj simptome gjendet si shoqëruese e 70 % të rasteve me esotropi dhe 30 % të rasteve me exotropi. Këto 2 raste mund të paraqiten në kuadrin e të ashtuquajturave sindroma A dhe V, të cilat shkaktohen për shkak të disfunksioni të muskulit oblik inferior. Mund të haset edhe si simptom i izoluar duke shkaktuar torticollis. Ekzistojnë 2 tipe të disfunksionit të muskulit oblik inferior: tipi primar (konjenital) i pranishëm që në lindje dhe evidentohet që në vitin e parë të jetës, zakonisht bilateral. Tipi i dytë, i fituar, është unilateral dhe shkaktohet si pasojë e parezës apo paralizës së muskulit oblik superior. Trajtimi i patologjisë është kirurgjikal dhe bazohet në dobësimin e muskulit oblik inferior.

**Metodat:** Disa teknika kirurgjikale janë propozuar deri tani si dezinserimi, ekstirpimi, denervimi, recesioni, myectomy dhe transpozicioni anterior i muskulit oblik inferior. Dobësimi i muskulit Oblik inferior fitoi popullaritet dhe u bë një nga metodat më të përhapura, që kur White dhe Brown e raportuan atë në vitin 1930. Aktualisht myektomia dhe recesioni i Muskulit Oblik Inferior janë teknikat më të përdorura kirurgjikale aktualisht. Anteriorizimi është një tjetër teknikë e fiksimit që rekomandohet të kryhet, sidomos kur hiperaksioni i muskulit Oblik Inferior shoqërohet me DVD (deviacion Vertikal i Disocijuar)

**Rezultatet:** do të paraqisim raste klinike që rezultojnë të suksesshme pas dobësimit të veprimit të Muskulit Oblik Intern kirurgjikalisht. Paraqitja e pacientëve me mosbalancim të veprimeve të muskulit jo vetëm horizontale por dhe vertikale, na ka dhënë shkas në hulumtimin dhe zbatimin e teknikave të ndryshme kirurgjikale për të pasur kirurgji strabizmi me rezultate të suksesshme. Një nga teknikat është dobësimi i veprimit të MOI, të cilin gjatë interventit, pas përparimit me kujdes të Tenonit e izolohet me kujdes dhe e transpozicionojmë pranë MRI.

**Konkluzionet:** Vendosja pothuajse posteriorisht e MOI e bën të vështirë ndërhyrjen kirurgjikale mbi të. Kryerja e hapave me kujdes dhe mënjanimi i hemorragjisë çojnë në rezultate të suksesshme.

## PO 03 Aplikimet e membranave amiotike në Oftalmologji

*Bërdica L., Bushati T.*

**Hyrje:** Membrana amiotike (MA) është shtresa e brendshme e membranave fetale dhe konsiston në 3 shtresa të ndryshme: Epiteli, shtresa bazale dhe stroma. Stroma konsiston në 3 shtresa të tjera të ndryshme në vazhdimësi me njëra-tjetrën por të ndryshme: pjesa kompakte e brendshme, shtresa e mesme fibroblastike si dhe shtresa e jashtme spongioze.

ente, mungesa e imunogjenecitetit si dhe aftësia për të pasur një substrat të shkëlqyer për rritjen, migrimin dhe adezionin e qelizave epiteliale korneale dhe konjuktivale, bën që ajo të përdoret në shumë mënyra për të rritur sipërfaqen e rikonstruksionit ocular në shumë patologji okulare që perfshi-

jnë çrregullimet korneale të shoqëruara me deficite të qelizave burimore të limbusit, kirurgji të rikonstruksioneve konjuktivale, si bartës për ekspansionin ex vivo të qelizave epiteliiale të limbusit, kirurgjive të glaukomës si dhe defekteve apo perforacioneve të sklerës.

**Metoda:** Megjithatë përdorimi pa kufi i MA duhet të kihet kujdes, pasi mund të shfaqen edhe komplikacione, pavarësisht së janë jo të shpeshta. Këto komplikacione përfshijnë transmetimin bacterial, viral ose fungal tek recipienti nëse dhuruesi nuk është kontrolluar më parë në mënyrën e duhur për sëmundje të transmetueshme, nëse MA nuk është procesuar në kushte sterile ose nëse kushtet e ruajtjes janë të papërshtatshme. MA është një material që lehtësisht mund të merret nga dhuruesi, pasi në realitet është një material që shkatërrohet pas lindjes së fetusit, mjafton një konsensus me shkrim për arsye legale. Më pas menjëherë MA dërgohet në një laborator të specializuar të Bankave Indore, ku i nënshtrohet vlerësimit të përshtatshmërisë dhe nëpërmjet një procesi me tre nivele sterilizimi realizohet përzgjedhja e sipërfaqeve të dhura dhe paketimi, pasi është analizuar me mostra bakterologjike dhe virologjike të disallojshme. Konservimi final bëhet në kontenitorë me azot të lëngshëm në temperaturë shumë të ulëta. Më pas, në rast nevojë bëhet dekonxhelacioni për t'u përdorur në rastet konkrete.

**Rezultati:** Vetëm nëse bëhet një selektim shumë i kujdesshëm i rasteve, mund të merren përfitimet maksimale.

#### PO 04 Teknikat e anestezisë në kirurgjinë mini-invazive në Oftalmologji

*Bilaj (Miraka) M., Bako A.*

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij studimi është të prezantojmë teknikat bashkëkohore të anestezisë në kirurgjinë mini-invazive në Oftalmologji si dhe të paraqesim eksperiencën tonë pranë Spitalit Amerikan si qendër që ofron shërbimin e anestezisë në kryerjen e të gjitha procedurave oftalmologjike nga kirurgjia e kataraktës deri tek transplantet korneale.

**Përkufizimi:** Kirurgjia oftalmologjike konsiderohet si një nga kirurgjitë më të shpeshta që kërkon anestezi në vendet e zhvilluara. Ajo klasifikohet si më e shpeshta në të moshuarit, një pjesë e madhe e të cilave mund të konsiderohen si kirurgji ditore. Anestezia në procedurat oftalmologjike kërkon njohje të mirë të koncepteve anatomike, farmakologjike dhe fiziologjike për të realizuar strategjinë anestetike. Përgjithësisht, ndërhyrjet oftalmologjike janë konsideruar si me risk të ulët, por pjesa më e madhe e këtyre pacientëve janë kryesisht të moshuar me sëmundje shoqëruese sinjifikante si DM, COPD, CRF, CHF etj., të cilat rrisin riskun e komplikacioneve anestetike. Për këtë arsye vlerësimi preoperator i këtyre pacientëve është shumë i rëndësishëm. Avancimi i teknikave të reja kirurgjikale në teknika gjithmonë edhe me mini-invazive si PhE, ka çuar në përdorimin e teknikave më pak invazive anestetike, duke ulur kështu ndjeshëm komplikacionet anestetike dhe rehabilitimin më të shpejtë të pacientëve. Mjeku anestezi duhet të ketë njohuritë dhe eksperiencën e duhur për të vlerësuar dhe shmangur komplikacionet e ndryshme si OCR, ORR, OER, rritjen e presionit intraokular, hemoragjinë, atakun e panikut dhe ruajtjen e parametrave jetësor. Teknikat anestetike më të shpeshta konsiderohen anestezia topikale, anestezia regionale (më i shpeshti blloku retrobulbar RBB) dhe anestezia gjenerale(GA).

**Materiali dhe metodat:** Janë marrë në studim 214 pacientë ASA I-III që i janë nënshtruar procedurave të ndryshme kirurgjikale oftalmologjike në periudhën 28 Maj 2018 - 28 Nëntor 2018 pranë Spitalit Amerikan 1 dhe korrelimi me teknikat e ndryshme anestetike të përdorura. Pacientët i janë nënshtruar vlerësimit preoperator nga mjeku anestezi dhe mjeku oftalmolog sipas protokollit standard të Spitalit Amerikan. Në sallën operatore (OR) është kryer monitorimi standart sipas ASA. Teknika e anestezisë është përcaktuar sipas llojit të kirurgjisë, preferencës së kirurgut, llojit të pacientit dhe sëmundjeve shoqëruese, eksperiencës së anestezistit për të realizuar strategjinë esenciale të anestezisë, minimizimin e lëvizjeve të pacientit, ruajtjen e presionit intraokular dhe ruajtjen e parametrave vitale.

Ndërhyrjet kirurgjikale të kryera: katarakta 129 pts (60.2%), glaukoma 4pts (1.8%), keratokonus 19 pts (8.9%), DCR 5pts (2.3%), trabismus 3pts (1.4%), pterigion 12 pts (5.6%), vitrectomy RD 9 pts (4.2%), transplant cornea 3 pts (1.4%), procedura të kombinuara 14 pts (6.5%), të tjera 16 pts (7.5%). Pacientët kanë qenë 115 pts (53.7%) (M) dhe 99 pts (46.3%) (F). Grupmosha 0-1 vjec 1pt (0.5%), 1-18 vjec 16 pts (7.5%), 18-70vjec 116 pts (54.2%), >70 vjeç 81 pts (37.8%).

Teknikat e anestezisë të përdorura: Anestezia topikale 185 pts (86.4%), anestezia regionale (RBB) 3 pts (1.4%), anestezia gjenerale (GA) 26 pts (12.1%).

**Rezultati:** Në studimin tonë teknika anestetike më e shpeshtë ka qenë anestezia topikale (86.4%). Mor-

taliteti 0%, konvertim të anesteziës topikale + sedacion në 5 pts 2.3%, luhatje të tensionit arterial në OR të dominuara me NTG (i/v) 21% pa komplikacione të tjera sinjifikante. Pacientët kanë dalë nga spitali në gjendje klinike dhe hemodinamike të mirë.

**Përfundimi:** Menaxhimi i anesteziës në Okulistikë kërkon njohjen dhe familjarizimin me preparatet dhe teknikat e ndryshme bashkëkohore oftalmologjike. Kujdes i veçantë duhet treguar në vlerësimin preoperator, perioperator dhe ndjekjen postoperative të pacientëve për të shmangur komplikacionet e ndryshme dhe për të siguruar reabilitimin sa më të shpejtë të pacientit.

### PO 05 Teknikat mikroinvazive në Kirurgjinë e Glaukomës (MIGS)

*Meço M.*

**Qëllimi:** Prezantimi i disa teknikave mikroinvazive në Kirurgjinë e Glaukomës dhe mundësitë reale të adaptimit të tyre në praktikën klinike.

**Metoda:** Shqyrtimi i literaturës për procedurat mikroinvazive në kirurgjinë e glaukomës: PubMed, Cochrane library. Vlerësimi i efikasitetit dhe profilit të sigurisë, që këto teknika paraqesin. Kombinimi i MIGS me kirurgjinë e kataraktes dhe krahasimi me procedure "solo". Eksperienca jonë përmes prezantimit të disa rasteve klinike. Rezultatet: U shqyrtuan mbi 40 publikime, botime në PubMed, Cochrane Library, Revista Oftalmologjike Internacionale, studime klinike mbi raste klinike të trajtuara me teknika kirurgjikale mikro-invazive (MIGS). Vlerësim specifik sipas çdo kategorie të MIGS (me drenim në kanalin e Schlem, me drenim në hapësirën suprahoroidale dhe me drenim në hapësirën subkonjuktivale). Krahasimi i efikasitetit të procedurave MIGS, të kryera "solo" dhe të kombinuara me kirurgjinë e kataraktes.

Në të gjitha këto studime, konfirmohet efikasiteti i këtyre procedurave mikroinvazive (MIGS), në reduktimin e presionit intraokular, duke çuar në reduktimin e numrit të medikamenteve antiglaukatoze të nevojshëm, e shoqëruar me një profil të lartë sigurie të këtyre procedurave, krahasuar me kirurgjinë tradicionale të glaukomës.

Eksperienca jonë me raste klinike është minimale, duke paraqitur nevojën e zgjerimit të aplikimit të këtyre procedurave. Pengesat kryesore që hasen në Klinikën reale në kushtet aktuale, lidhen me koston e lartë të këtyre procedurave dhe një "learning curve" afatgjatë.

**Konkluzion:** Teknikat mikro-invazive në kirurgjinë e glaukomës (MIGS) kanë profil të lartë sigurie dhe vlerësohen si efektive në reduktimin e presionit intraokular, duke çuar në pakësimin e numrit të medikamenteve, sidomos në stadi të hershme sëmundjes. Kostoja e lartë e këtyre teknikave mikroinvazive mbetet aktualisht një pengese reale, për adaptim më të gjerë të tyre, në praktikën klinike, në kushtet tona.

### PO 06 Teknika mini-invazive Cross-linking në trajtimin e keratokonusit

*Haveri T.*

**Hyrje:** Keratokonusi bën pjesë në sëmundjet degjenerative të kornesë, e cila paraqitet zakonisht rreth moshës së adoleshencës, në trajtën e uljes progresive të pamjes. Shkaku qëndron në hollimin progresiv dhe me arsye të paqarta të kornesë, që sjell për pasojë deformimin e saj, nga sipërfaqe e sheshtë asferike në konike. Si pasojë, shikimi ulet ndjeshëm dhe mprehtësia e pamjes më të mirë të korigjuar (BCVA) reduktohet. Në stadi ekstrem të evolucionit, kornea hollohet shumë dhe rrezikon perforacionin dhe kështu humbjen definitive të pamjes. Prej mëse 10 vjetësh, një metodë minimalisht invazive, e njohur me emrin "corneal cross-linking", e bazuar në aplikimin e Sol. vitaminës B6 dhe rrezeve ultraviolette me gjatësi 365 përdoret me sukses në Spitalin Amerikan për frenimin e progresivitetit të keratokonusit.

**Qëllimi:** Synon të përshkruhen simptomat dhe ankesat kryesore që paraqesin pacientët e prekur nga keratokonusi. Të përshkruhen metoda diagnostikuese e keratokonusit dhe përcaktimi i stadi të tij nëpërmjet topografisë korneale 3 dimensionale (Pentacam); të shpjegohen indikacionet për cross-linking në stadi të hershme 1- 3 dhe për transplant të kornesë në stadi të avancuara >4t.

Qendra e aplikimit: Klinika e Okulistikës Spitali Amerikan Nr.1 Tirana.

**Metoda:** Cross-linking është deri me sot, e vetmja metodë e njohur, minimalisht invazive, që është demonstruar e suksesshme në frenimin e progresit të keratokonusit. Metoda bazohet në aplikimin e solucionit të Vitaminës B6 (riboflavinës) oftalmike, për 30 minuta dhe më pas kornea irradionet me

rrezatim ultraviolet me gjatësi vale 365 nm per 30 minuta. Për të rritur shkallën e depërtimit të solucionit të riboflavinës në stromën korneale, paraprakisht largohet mekanikisht epiteli i kornesë në një rreze 8 mm. Ndërveprimi i këtyre dy faktorëve shkakton rritje të numrit të fibrave gjatësore dhe transversale të kornjese, fenomen i cili jep rritje të fortësisë kornesë dhe të strukturës së saj, duke e bërë me rigide. Një korne e tillë më e fortë nuk hollohet apo deformohet. Me procedurën e cross-linking shoqërohet me mjekim post operator me solucion antibiotic dhe antiinflamator për 3 javë. Pacienti ndiqet pas 1 jave, dhe në periudha të ndryshme kohore rregullisht deri në 5 vjet. Kriteret e ndjekjes janë mprehtësia e pamjes më të mirë me/dhe pakorrigjim (UCVA, BCVA) si dhe parametrat topografike: rrezet e keratometrive korneale më e sheshtë (flattest), më e lartë (steepest) keratometria maksimale dhe pakimetria korneale.

**Rezultatet:** Duke filluar nga muaji i 6-të pas cross-linking vihet re reduktim progresiv i keratometrive maksimale deri në 6 dioptri, keratometrite flattest dhe steepest pësojnë reduktim 2-3 dioptri, pakimetria reduktohet gradualisht me 20 um, fenomen i cili njihet si “corneal shrinking”.

Mprehtësia e pamjes së pa korrigjuar, fillon të rritet gradualisht pas 6 muaj me 1 rresht në tabelën Snellen, ndërsa BCVA deri në 2 rreshta Snellen. Këto ndryshime janë statistikisht të rëndësishme dhe të qëndrueshme edhe pas 5 vjetësh.

**Konkluzion:** Keratokonusi është sëmundje e moshave të reja, me incidencë në rritje në vitet e fundit dhe me pasoja serioze për shikimin. Përdorimi i topografisë korneale 3 dimensionale (Pentacam) mundëson diagnozën e hershme të sëmundjes. Aplikimi i hershëm i procedurës cross-linking, një metodë minimalisht invasive, stabilizon kornenë, e bën atë me rigide, dhe nuk lejon deformimin e mëtejshëm të saj. E aplikuar në stadet e hershme, cross-linking ëshë një procedurë e sigurt dhe pa komplikacione. Rezultatet tona eidentojnë efikasitetin e saj në stabilizimin e strukturës së kornesë dhe frenimin e progresit të keratokonusit. Në stadet e avancuara të keratokonusit, me trashësi shumë të reduktuar të pakimetrisë korneale, çarje në Descemet apo rrezik perforacioni, zgjidhja më e mirë është transplant i kornesë.

## PO 07 Lamellar keratoplasty a mini invasive approach of corneal transplants

*De Sanctis U.*

**Purpose:** To describe the surgical technic of DALK/DSAEK/DMEK. To discuss the corneal pathologies which require corneal transplantation and to explain the advantages of DALK/DSAEK/DMEK in rapport with penetrating keratoplasty (PK) - Choice of DALK/DSAEK/DMEK in keratokonus and other corneal ectasia treatment.

**Material and method:** Describing step by step diagnose and decision for keratoplasty. Reasons for choosing the type of corneal transplantation (Lamellar or PK).

**Discussion:** DALK/ is a partial-thickness cornea transplant procedure that involves selective transplantation of the corneal stroma, leaving the native Descemet membrane and endothelium in place. DSAEK/DMEK is another approach of lamellar corneal transplant that are focused of replacing only the endothelium, the inner part of the cornea, saving the stroma and epithelium of the patient. A trephine of an appropriate diameter is used to make a partial-thickness incision into the patient's cornea, followed by pneumodissection or manual dissection of the anterior stroma. This is followed by placement of a graft prepared from a full-thickness punch in which the donor endothelium-Descemet membrane complex has been removed. The intention is to preserve the patient's Descemet membrane and endothelium. DALK is useful for processes involving the corneal stroma in the presence of healthy endothelium.

**Result:** Because it is not a full-thickness procedure, the resultant wound is stronger than that of a PK. Leaving the host endothelium intact significantly decreases the risk of endothelial rejection. DSAEK/DMEK is realized after removing the endothelium of the patient and applying the donors descemet against the patients stroma by an air bubble.

It is mostly indicated for endothelial dystrophy, keratopathia bulosa etc.

Both techniques of lamellar keratoplasty are focused in preserving some original tissue of the patient that decrease significantly the rejection rate and increase the time survival of the graft. Also a quicker and better rehabilitation in visual acuity is seen.

Drejtoria e Strategjisë Akademike dhe Edukimit Mjekësor

# KONFERENCA MJEKËSORE NEFROLOGJI-KIRURGJI VASKULARE

Fokus: "Terapia renale zëvendësuese, sfidat për të ardhmen"

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
28 Mars 2019 | 15:00 - 18:00



## PROGRAMI SHKENCOR:

Moderatore: Dr. Shk. Arjana Strakosha, Dr. Fjona Nasto

**15:00-15:20 - Indikacionet dhe koha e fillimit të Terapisë Renale Zëvendësuese tek Insuficenca Renale Akute.**

Dr. Elvana Rista  
Shefe e Departamentit të Nefrologjisë, Spitali Hygeia

**15:20-15:40 - Menaxhimi i anemisë në SRK.**

Dr. Nasian Mosku  
Mjek pranë Qendrës së Dializës, Spitali Rajonal Korçë

**15:40-16:00 - Trajtimi i Flakjes Akute tek pacientët e transplantuar renal.**

Dr. Arjeta Dedej  
Mjeko Nefrologe, Spitali Amerikan

**16:00-16:15 - Vlerësimi me Echo Doppler si ekzaminim i domosdoshëm në periudhën post-transplant.** Dr. Adriatik Daku

Mjek radiolog, Spitali Amerikan

**16:15-16:35 - Edukimi multidisiplinor i pacientëve me sëmundje renale kronike.**

Dr. Shk. Dhurata Golemi  
Shefe e Departamentit të Nefrologjisë, Spitali Rajonal Shkodër

**16:35-16:50 - Komplikacionet afatshkurtra dhe afatgjata të katetereve të Hemodializës.**

Dr. Fjona Nasto  
Shefe e Departamentit të Nefrologjisë, Spitali Amerikan

**16:50-17:10 - Aksesit vaskular tek pacientët me Hemodializë.**

Dr. Bledar Hodo  
Mjek Kirurg kardiovaskular, Spitali Amerikan

**17:10-17:30 - Përmirësimi i Anemisë renale me EPO humane rekombinante tek pacientët me Insuficiencë renale në program të Hemodializës.**

Dr. Mimoza B. Ukimeraj  
Mjeko Nefrologe, Qendra Klinike Universitare, Prishtinë, Kosovë

**17:30-17:50 - Sfidat e trajtimit të hiperparatiroidizmit sekondar tek pacientët me sëmundje renale kronike.**

Dr. Denada Haxhiu  
Mjeko Nefrologe, Spitali Amerikan

**17:50-18:00 - Diskutime, Konkluzione**

Kategoria e pjesëmarrësve: mjekë klinikistë, nefrologë, kirurgë, okulistë, patologë, anestezistë, farmacistë, infermierë, etj.

Organizuar nga Shoqata AMEA – Albanian Medical Education Association

## KOMITETI ORGANIZUES

**Klodian Allajbeu**  
Drejtor i Përgjithshëm  
Spitali Amerikan

**Lindita Shosha**  
Drejtoresh e Strategjisë Akademike  
dhe Edukimit Mjekësor

**Mario Karaj**  
Drejtor i Menaxhimit Spitalor  
Spitali Amerikan

**Onejda Ymeraj**  
Drejtoresh Operacionale  
Spitali Amerikan

## Sekretare Organizative

**Albana Mehmeti**  
Koordinatorë e Edukimit në Vazhdim


Email: [albana.mehmeti@spitaliamerikan.com](mailto:albana.mehmeti@spitaliamerikan.com)

Web: [www.imca.al](http://www.imca.al)

Mob: 0684032151



*Dr. Fjona Nasto*



*Dr. Shkë. Dhurat Golemi*




*Dr. Arjeta Dedej*



*Dr. Nasian Mosku*



*Dr. Denada Haxhiu*



*Dr. Mimoza B. UkimeraJ*



*Dr. Bledar Hodo*



*Dr. Elvana Rista*



*Dr. Adriatik Daku*

**PO 08 Vlerësimi me Echo Doppler si ekzaminim i domosdoshëm në periudhën post transplant***Daku A.*

**Hyrje:** Transplanti i veshkave është trajtimi i zgjedhur për menaxhimin e pacientëve me sëmundje renale kronike në fazën përfundimtare. Duke iu nënshtruar një procedure shumë kirurgjikale, marrësit e transplantit të veshkave mund të përfitojnë nga ndjekja e imazhit dhe strategjitë e monitorimit.

Echo dopleri konsiderohet si test i imazhit kryesor në vlerësimin e transplanteve renale. Është një ekzaminim lehtësisht i zbatueshëm edhe pranë shtratit të pacientit që mund të zbulojë komplikacione të mundshme dhe të drejtojë imazhin ose ndërhyrjen e mëtejshme. Në këtë rishikim të imazhit, ne paraqesim informacione thelbësore lidhur me tiparet sonografike të transplanteve të sukseshem të veshkave, duke detajuar teknikën kirurgjikale dhe si ndikon në anatominë.

Ne përqendrohemi në komplikacione të ndryshme që ndodhin pas transplantimit të veshkave dhe tipareve të tyre sonografike duke shqyrtuar burimet përkatëse të literaturës dhe arkivat tona të imazheve. Në protokollin e spitalit tonë – Spitali Amerikan - një echo dopler i parë kryhet në 24-48 orët e para të transplantimit. Një protokoll i hollësishëm i ekzaminimit përfshin madhësinë renale dhe echogenicitetin, sistemin e kolektor, gjendjen ureterit dhe vlerësimin e çdo koleksioni postoperative.

Kontrolli i parë identifikon çdo komplikacion të hershëm që mund të duhet të ndiqet urgjentisht për të siguruar transplantin. Ekzaminimi me ngjyra Doppler lejon vlerësimin e shpejtë të të gjithë perfuzionit arterial të veshkave dhe atë venoz. Gjithashtu, ai lejon vizualizimin e arteries renale kryesore me ndarjet e saj të mëparshme dhe të pasme, arteriet segmentare, interlobare arkuate dhe venat korresponduese brenda graftit. Arteria kryesore renale tregon formën normale valë Doppler me shpejtësi të rrjedhjes që varion nga 20 deri në 52 cm / sek. Indeksi rezistencës (RI) përdoret si matje e rezistencës ndaj rrjedhës arteriale brenda shtratit vaskular të veshkave. Një RI më pak se 0.7 në 0.8 konsiderohet normale dhe nëse RI tejkalon 0.8, është një tregues i mosfunksionimit të transplantit.

**PO 09 Trajtimi i Flakjes akute tek të sëmurët me sëmundje renale kronike***Dedej A.*

Pacientët me sëmundje renale kronike kanë si mundësi trajtimi: hemodializën, dializën peritoneale dhe transplantin renal. Transplanti renal është trajtimi i preferuar për këta pacientë për gjithë impaktin social por edhe ekonomik. Flakja akute (FA) është një ndërlikim i zakonshëm në transplantin renal megjithë shtimin e imunosupresorëve të rinj në terapinë e këtyre pacientëve. Është shkaku kryesor i Disfunksionit të Allograftit. Në disa raste allografti nuk arrin ta rimari funksionin me gjithë terapinë maksimale kundër flakjes, duke dhënë kështu humbje të tij. Flakja akute shoqërohet me mbijetesë të reduktuar të transplantit, duke ndikuar kështu dhe në jetëgjatësinë e këtyre pacientëve. Flakja mund të ndodhë brenda disa orëve pas ndërhyrjes dhe kategorizohet si flakje sub-akute në më pak se tre muaj flakje akute ose pas tre muajsh të transplantimit flakje kronike.

Transplantet me donator të gjallë, me lidhje familjare brenda të njëjtës racë, duke u kompletuar dhe me gjithë protokollin e ekzaminimeve të përputhshmërisë (HLA+Crossmatch) dhe në sajë të terapisë me imunosupresore të filluar përpara ndërhyrjes, ulin në maksimum mundësinë e flakjes sub-akute.

Trajtimi i flakjes hiperakute është Nefrektomia.

Përsa i përket flakjes akute, trajtimi është me pulse metilprednisolon, ATG, plazmaferezë dhe rrallë herë nefrektomi si për flakjen hiperakute.

Ndërsa trajtimi për flakjen kronike nuk është specific d.m.th. varet nga shkaktarët që mund të jenë DSA ab, toksiciteti nga ciklosporina dhe tacrolimus, stenoza a.renale, glomerulonefrit de novo, etj.

Eksperinca për flakjet në Spitalin Amerikan është në shifra shumë të ulëta. Tashmë janë kryer 170 transplante gjithsej dhe pacientë me flakje hiperakute nuk rezultojnë asnjë, ndërsa pacientë me flakje akute rezultojnë 18, pra rreth 10.8 %, shifër kjo e ulët e krahasuar me statistikat mbarëbotërore. Për pacientët me flakje kronike nuk ka statistika të sakta, pasi pacientët janë të shpërndarë në qendra të ndryshme për ndjekje. Do të paraqisim protokollin e diagnostikimit dhe të trajtimit të rasteve me flakje akute dhe raste specifike konkrete.

**PO 10 Akseset vaskulare tek pacientët e dializës***Hodo B.*

Planifikimi i aksesit vaskular është një hap i rëndësishëm për pacientët që fillojnë hemodializën. Për të kryer një seancë hemodialize efektive është e rëndësishme rruga që përdoret për të kryer qarkullimin e gjakut nga pacienti në aparatit të hemodializës. Më poshtë do trajtojmë akseset vaskulare që përdorim sot.

Tre janë akseset vaskulare: Fistul arterio-venoze, Graft arterio-venoz dhe Kateter.

Zgjedhja e parë dhe më e mira është Fistula Arterio-Venoz (FAV). Hapja e FAV duhet kryer një ose dy muaj para fillimit të hemodializës për arsye se duhet një periudhë kohore 1-3 muaj që të jetë në gjendje të përballoj hemofiltrimin. Vendi ku bëhet fistula zgjidhet në bazë të kualitetit të venës dhe arteries pasi vlerësohen me eko Doppler. Diametri i venës >2mm dhe diametri i arteries >1.6mm janë dy parametra të rëndësishëm për planifikimin e FAV. Sipas guidelineeve tre janë akseset më të përshtatshme: parakrahu (FAV radio-cefalike), bërryli (FAV brakio-cefalike) dhe krahu (FAV brakio-bazilike). Fistula më e mirë konsiderohet ajo në nivelin e kyçit, për arsye



se është më e thjeshtë për t'u formuar, komplikacionet janë minimale dhe funksionimi afatgjatë është shumë më i mirë. Sipas literaturës në fund të vitit të parë 56-79% e fistulave distale dhe 70-84% e fistulave proksimale janë funksionale. Sipas guidelineeve që një fistulë të jetë gati për ndërhyrje duhet: fluksi i venës >600mL/min, diametër i venës >0.6cm dhe vena duhet të jetë jo më thellë se 0.6cm.

Hapi i dytë është vendosja e grafitit arterio-venoz. Në rastet kur venat nuk janë të përshtatshme për FAV, përdoret graft sintetik me diametër 6mm ose 7mm për të lidhur arterien me venën e përshtatshme. Arteria dhe vena ku planifikohet vendosja e grafitit duhen vlerësuar me Eko Doppler për të evituar ndonjë stenoz ose tromboz të mundshme. Sipas literaturës diametri i venës ku do vendoset grafti duhet të jeteë >4mm. Duhet 3-6 javë kohë që grafiti të jetë i përshtatshëm për përdorim.

Kateteret venoze centrale janë zgjedhja më e mirë në rastet kur pacienti duhet të futet në dializë sa më parë, ose kur planifikohet transplant për një kohë të shkurtër. Vendet më të preferuara janë v.jugulare interna, v.femorale dhe v.subklavia. Vendosja e kateterit këshillohet të bëhet me ndihmën e eko's për të qenë sa më të saktë dhe për të evituar komplikacionet që mund të ndodhin. Komplikacionet shkaktuar nga kateteri janë të shumta si: hematomat lokale, dëmtim i venave, pneumotoraks, trombozë e venave, infeksion (endokardit), stenozë të venave, tromboemboli pulmonare etj.

## **PO 11 Sfidat e trajtimit të hiperparatiroidizmit sekondar tek pacientët me sëmundje renale kronike**

*Haxhiu D.*

**Hyrje:** Hiperparatiroidizmi sekondar është një komplikacion i zakonshëm i Sëmundjes Renale Kronike, që karakterizohet nga hipersekretimi i parathormonit dhe hiperplazia e paratiroides. Patogjeneza është komplekse dhe përfaqëson një përgjigje kompensatore ndaj niveleve të reduktuara të kalciumit serik, vitaminës D aktive dhe niveleve të rritura të fosforit serik. Manifestimet klinike karakterizohen nga dhimbje të kockave dhe muskujve, dobësi trupore dhe kufizim të lëvizjeve, fraktura, prurit, kalçifikime vaskulare etj.

**Qëllimi:** Ky studim synon të përcaktojë prevalencën e hiperparatiroidizmit sekondar në qendrën e hemodializës së Spitalit Amerikan Tirana 3.

**Metodat dhe materialet:** Studimi është deskriptiv i realizuar tek 63 pacientë të trajtuar me hemodializë kronike 3 herë në javë në qendrën tonë të hemodializës në periudhën Janar 2018 - Dhjetor 2018. Të gjithë pacientëve i është dozuar niveli serik i PTH (dy herë në vit), Vit D (një herë në vit), fosforemisë dhe kalçemisë (çdo muaj).

**Rezultatet:** Në studim u përfshinë 63 pacientë nga të cilët 21 ishin femra dhe 42 meshkuj. Metodatat e trajtimit të pacientëve janë: Kufizimin dietik i fosforit, trajtimi me medikamente me lidhësit e fosforit, analogët e Vitaminës D aktive dhe kalcimimetiket. Vetëm një rast është trajtuar me paratiroidektomi. Rezultoi se 25.4% e pacientëve kishin  $PTH \leq 150$  pg/ml, 23.8% ishin me nivele të pranueshme të PTH (150-300 pg/ml), 19% e pacientëve kishin  $PTH (300-600$  pg/ml), 14.3% e pacientëve rezultuan me  $PTH (600-1000$  pg/dl) dhe 17.5% e tyre rezultuan me  $PTH \geq 1000$  pg/dl.

**Konkluzione:** Vihet re një prevalencë e lartë e pacientëve me vlera të PTH mbi 1000 pg/dl pavarësisht trajtimit me medikamente. Nëse nuk trajtohet në mënyrë adekuate hiperparatiroidizmi sekondar përparon në mënyrë të pandalshme dhe reflektohet me rritjen e niveli i PTH në raport të drejtë me numrin e viteve në dializë.

## **PO 12 Edukimi multidisiplinor i pacientëve me sëmundje renale kronike**

*Golemi Dh.*

**Hyrje:** Ngarkesa e sëmundjes renale kronike (SRK) është prezente dhe është e shoqëruar me morbozitet, mortalitet dhe kosto të lartë të kujdesit shëndetësor. Edukimi multidisiplinor Predializë (EMP) i pacientëve me SRK është në fokus të shumë studimeve.

Shumë prej tyre tregojnë që edukimi ndikon në uljen e shkallës së filtracionit glomerular (ShFG), zgjat kohën për fillimin e dializës dhe përmirëson prognozën afatgjatë të pacientit.

**Metoda:** Gjatë periudhës 2015- 2017 në Shërbimin e Poliklinikës të gjithë pacientët me SRK me  $ShFG, 15$  ml / min <  $ShFG < 60$  ml/min (stadi III – IV) janë përfshirë në studim dhe u ofrohet të gjithë pacientëve EMP.

Ndahen në dy grupe: grupi që përfshihet në EMP dhe grupi që nuk përfshihen në të. Ne krahasuam rënien e filtracionit glomerular, incidencën e fillimit të dializës dhe mortalitetin në dy grupet. EMP u zhvillua në bazë të udhërrëfyesve NKF/ DOQI.

**Rezultatet:** Gjithsej 120 pacientë, 60 të përfshirë në EMP dhe 60 që nuk marrin pjesë në EMP. Kohëzgjatja e studimit 24 muaj. Ulja mesatare vjetore e filtracionit glomerular ishte 1.4 ml/min ndaj 2.5 ml/min në grupin EMP, krahasuar me grupin jo EMP. Dializa u fillua në 1.7% krahasuar me 2,5 % në grupin jo EMP. Vdekshmëria ishte 1.7% dhe 8.3% në EMP ndaj jo EMP.

**Konkluzionet:** Një program eficient i standartizuar zgjat progresionin e SRK, ul incidencën e dializës dhe redukton morbozitetin dhe mortalitetin nga të gjitha shkaqet në pacientët me SRK.

## **PO 13 Indikacionet dhe koha e fillimit të terapisë renale zëvendësuese tek Insuficenca renale akute**

*Rista E.* **Hyrje:** Tradicionalisht, insuficenca renale akute është përkufizuar si një rënie e shpejtë (prej disa orësh deri disa javësh) dhe zakonisht e rikthyeshme e shpejtësisë së filtracionit glomerular.

Insuficenca Renale Akute (IRA) gjatë hospitalizimit është e shoqëruar me ditëqëndrim të zgjatur në spital, morbiditet dhe mortalitet të rritur.

Në pacientët që trajtohen në njësinë e kujdesit intensiv dhe komplikohen me IRA, e cila kërkon terapi renale zëvendësuese (TRZ), shkalla e mortalitetit të raportuar varion nga 40-60%.

Fillimi i dializës në IRA parandalon gjendjen e uremisë dhe vdekjen nga komplikacionet e insuficencës renale. Metoda: Indikacionet urgjente përfshijnë mbingarkesën volumore refraktare ndaj diuretikeve, hiperkaliemi severe, shenjat e uremisë siç janë perikarditi, encefalopatia, rënia e statusit mendor e pashpjeguar nga probleme të tjera, acidoza metabolike e rëndë, disa alkole të caktuara dhe intoksikimi nga medikamente të dializueshme.

Koha e fillimit të TRZ është shumë e rëndësishme. Fillimi i hershëm i TRZ ofron stabilizim më të shpejtë të elektroliteve dhe ekuilibrit acido-bazik, kontroll më të mirë të komplikacioneve të uremisë dhe mbingarkesës volumore, por, ka dhe disa komplikacione të cilat janë të dyshimta në lidhje me fillimin e hershëm të TRZ pa pasur indikacione të qarta. Pacientet të cilët do të fillojnë dializën duhet të pajisen me kateter venoz central, ekspozimin e gjakut në qarkullim ekstrakorporal, antikoagulim dhe më e rëndësishmja ndryshimet hemodinamike jatrogjenike mund të çojnë në vonesë të procesit të rikuperimit të funksionit të veshkës.

Problematika në lidhje me kohën më të përshtatshme për fillimin e TRZ është prioritet në fushën kërkimore të sëmundjeve renale.

**Konkluzione:** Përfundime të shumë kërkimeve të rëndësishme nuk kanë demonstruar përfitime nga fillimi i hershëm i TRZ. Gjithashtu, të dhënat nuk sigurojnë superioritet të terapisë continua nga ajo intermitente.

#### PO 14 Kateteret e Hemodializës

*Nasto F.*

**Hyrje:** Kateteret e hemodializës janë konsideruar si një “e keqe e domosdoshme”. Ato sigurojnë një qasje të menjëhershme dhe të besueshme për pacientët me hemodializë, prandaj përdorimi i tyre po rritet vazhdimisht.

Kateteret e dializës përdoren ose si zgjidhje e përkohshme ose si e përhershme, ndërsa pacientët presin për maturimin e fistulës ose transplantin e veshkave. Komplikimet që lidhen me aksesin e dializës, dhe sidomos me kateteret e dializës, janë në rritje, pasi pacientët me diagnozë me sëmundjen renale të fazës së fundit (ESRD) po rriten si në moshë, ashtu edhe në bashkë morbiditet.

Pacientët e hemodializës aktualisht kanë norma të larta morbiditeti dhe vdekshmërie.

Komplikimet kryesore që lidhen me kateteret e hemodializës përfshijnë trombozat dhe veshjen me fibrinë, stenozen qendrore të venës dhe okluzionin, si dhe infeksionet. Rrjedhimisht, dizenjimet më të reja të kateterit që synojnë të trajtojnë këto çështje, janë zhvilluar me risitë mbi produktet ekzistuese.

Tromboza dhe veshja e fibrinës mund të çojnë në hemodializë joadekuate, kryesisht duke prishur rrjedhën dhe duke kufizuar hyrjen përmes lumenit arterial. Shkëmbimi i kateterit ose zhveshja e fibrinës mund të përmirësojnë rrjedhën, por, gjithashtu, paraqesin rrezik të mëtejshëm për komplikimet e ardhshme. Vetë anti trombogjenike e një kateteri mund të jetë të rëndësishme për jetëgjatësinë, duke marrë parasysh që thrombi dhe formimi i qafës së fibrinës fillojnë sa më shpejt që 24 orë pas futjes. Zhvillimi i vazhdueshëm i biomaterialeve të kateterit, veshjet dhe hartat tip, reflekton nevojën për qëndrueshmëri më të mirë, pasi koha mesatare e qëndrimit është pak më shumë se dy muaj. Shumica e largimeve të paplanifikuara të kateterit janë për shkak të infeksionit dhe funksionimit të dobët. Rezultati: Do të paraqesim eksperiencën tonë përgjatë një viti në 8 (tetë) qendra hemodialize. Pacientët janë paraqitur kryesisht pa asnjë akses vaskular dhe kateteret si akses vaskular janë mbajtur për rreth një vit, ku gjatë kësaj kohe pacienti ka qenë në listë pritje për hapjen e një aksesit tjetër vaskular. Kjo ka rritur komplikacionet e këtyre pacientëve dhe përqindjet e morbiditetit dhe mortalitetit.

#### PO 15 Përmirësimi i anemisë renale me EPO humane rekombinante tek pacientët me Insuficiencë renale në program të hemodializës

*Ukimeraj B. M1., Hasangjekaj V.<sup>1</sup>, Ukimeraj Z. A.<sup>2</sup>, Rudhani I.<sup>1</sup>*

**Hyrje:** Në të sëmurët me sëmundje renale kronike, shoqëruesja më e shpeshtë është anemia renale. Anemia renale vjen si rezultat i mungesës së eritropoietinës dhe janë veshkat ato që kanë aftësi të madhe në sintetizimin e saj, diku mbi 90%. Zakonisht, kjo anemi është normokrome dhe normocitare në përshkrimin e strishos periferike. Eritropoietina është hormon që kontrollon eritropoezën gjerësisht prodhimin e eritrociteve. Është një citokinë (proteinë sinjalizuese molekulare) për eritrocite prekursorë në palcën kockore. Njihet edhe me emrat hematopoetina, hemopoetina apo edhe me shkurtësën ndërkombëtare EPO. Eritropoietina ekzogjene prodhohet me teknologji të rikombinimit të ADN-së tek kulturat qelizore. Intervenimi me kohë me Eritropoietine rekombinante humane dhe mbajtja e vlerave optimale luan rol të rëndësishëm në kualitetin e jetës dhe mbijetesës së këtyre të sëmurëve. Anemia sipas OBSH përkufizohet me ulje të koncentrimin të Hgb <13.0 gr/dl te meshkujt dhe <12.0gr/dl te femrat.

**Qëllimi i studimit:** Përcjellja e parametrave kliniko –laboratorike të eritrociteve, hemoglobinës, hematokritit pas aplikimit të beta-eritropoietinës s/c si dhe mbijetesës së të sëmurëve me IRK në dializë varet nga aplikimi i EPO beta

s/c. Janë përfshirë në studim moshë mbi 18 vjeç. Gjithashtu, të gjithë pacientët janë në program të rregullt të hemodializës në periudhë 24 mujore - koha e trajtimit në hemodializë mbi 12 muaj. Mbledhja e të dhënave u krye, duke u bazuar në të dhënat e dokumentuara të sëmurëve në hemodializë, në anamnezën e tyre si dhe në vlerësimin klinikolaboratorik të tyre. Të gjithë janë trajtuar me Epo beta s/c. Intervalet e injektimit janë tri herë në javë, dy herë në javë ose një herë në javë me 2000UI s/c pavarësisht nga indikacioni.

**Metodat:** Punimi është realizuar tek të sëmurët e Klinikës së Nefrologjisë me Hemodializë në QKUK Prishtinë. Numri i rasteve të përfshira në studim janë 80 raste raporti në mes femrave dhe meshkujve është: 41 meshkuj (51.2%) dhe 39 femra (48.8%). Përsa i përket grupmoshës së të sëmurëve, moshë mesatare është në mes 48-67 vjeç, më e vogla 23 vjeç dhe më e madhja 77 vjeç. Moshë mesatare femra  $61 \pm 9.6\%$ , meshkuj  $55.9 \pm 12.8$ . Kohëzgjatja e trajtimit me Hemodializë ka zgjatë prej minimum 5 vite dhe maksimum 17 vite. Te këta të sëmurë me Nefriti Kronik janë gjithsej 38 (47.5%) raste, Diabet Melit dhe NPD 27 (33.8%) raste, Hipertension Arterial dhe CMP hipertensive gjithsej 12 (15.0%) raste, Nephropathia obstructivae obsCa 1 (1.3%) raste, Syndroma nephroticum 1 (1.3%) raste dhe Nephrolithiasis bill gjithsej 1(1.3%).

**Rezultatet:** Si një prej parametrave të mundshëm për të dëshmuar efikasitetin e Epo-së kemi vlerësuar ndryshimin e numrit mesatar të eritociteve, Hgb, Hct, leukociteve, trombociteve dhe Fe në periudhën 24 mujore, çdo gjashtëmujor, gjithsej katër matje krahasuese. Numri mesatar i Eritrociteve dhe Hgb sipas katër gjashtëmujorëve, si vlerë bazike ka qenë gjashtëmujori i parë, kështu që numri i eritociteve dhe Hgb ka treguar rritje në gjashtëmujorin e katërt, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të të gjitha grupeve krahasuese. Gjatë periudhës dy vjeçare vlerat e Eritrociteve kanë qenë vlerat min  $2.20 \times 10^6$ mm dhe kanë arritur max eritrocitet  $3.57 \times 10^6$ mm, te hemoglobina kanë qenë vlerat min Hgb74 g/dl dhe max Hgb 118g/dl. Vlerat mesatare te Hct kanë treguar rritje variabile krahasuar me gjashtëmujorin e parë. Rritje mesatare është shënuar në gjashtëmujorin e tretë dhe katërt vlerat min Hct 20.4% dhe max Hct 35.0%. Vlerat e hekurit kanë treguar lëvizje variabile me rritje në gjashtëmujorin e dytë dhe atë të katërt. Vlerat min Fekane 7.21, kurse Fe max 27.95. Të sëmurët janë trajtuar me preparate të hekurit sipas protokollit.

**Përfundimi:** Sipas rezultateve të hulumtimit kemi arritur të deshmojmë efikasitetin e Eritropoetinës beta me mënyrë administrimi s/c. Rezultatet e hulumtimit tonë janë të pranueshme. Bazuar në Udhërrëfyesin e Asociacionit Evropian në studimin tonë, dallimi i vetëm sinjifikant ka qenë te administrimi i dozimit mesatare javore i Epo-së. Trajtimi i anemisë renale me Epo ekzgjene humane rekombinante, çon në përmirësimin e një serë parametrash klinike, përmirëson kualitetin e jetës dhe zvogëlon mortalitetin.

## PO 16 Menaxhimi i anemisë në SRK

Mosku N.

**Hyrje:** Menaxhimi i pacientëve në hemodializë është kompleks dhe kërkon vëmendjen e duhur. Problematika më e rëndësishme tek pacientët me hemodializë është krijimi dhe ruajtja e aksesit vaskular. Pas kësaj vijnë të tjerat me radhë si ruajtja e shëndetit të kockave, trajtimi i anemisë sekondare që vjen nga SRK, ruajtja e funksionit kardiak, menaxhimi i tensionit arterial, ruajtja e balancës hidroelektolitike.

**Metoda:** Këtu do trajtojmë menaxhimin e anemisë te pacientët me SRK.

Anemia përkufizohet si një gjendje, në të cilën sasia ose cilësia e eritrociteve është nën kufijtë e poshtëm të normës sipas kategorive të caktuara. Pacientët me SRK janë të predispozuar të vuajnë nga anemia për disa arsye: Ulja e prodhimit të EPO, deficienca funksionale dhe/ose absolute ne hekur, humbjet kronike të gjakut në setet e aparatit të hemodializës etj.

Disa nga pasojat e anemisë nëse nuk trajtohet janë: ulje të përdorimit të oksigjenit, rritje të debitit kardiak dhe probablisht hipertrofi të ventrikulit të djathtë, ulje të përqëndrimit dhe aftësive konjitive, ulje të forcave imunitare, etj.

**Konkluzion:** Trajtimi i kësaj lloj anemie ka sfidat e veta. Pikë së pari, duhen përjashtuar shkaqet e tjera që sjellin anemi. Administrimi i hekurit dhe agjenteve stimulues të eritropoezës duhet të ndiqet me teste që tregojnë efektshmërinë e tyre. Rezistenca ndaj këtyre të fundit është një koncept i ri që po futet në këtë kategori pacientësh.

Në dekadat e fundit një rëndësi gjithmonë e më e madhe, po i jepet rolit të deficiencës së hekurit në këtë lloj anemie.

Tek pacientë me SRK ekziston një gjendje inflamatore kronike komplekse që e bën të vështirë diagnozën e deficiencës së hekurit, sidomos kur përdoren markerat klasike si sideremia, TIBC apo ferritinemia. Në vitet e fundit vëmendja është zhvendosur të shenjuesit e rinj të deficiencës në hekur.

Drejtoria e Strategjisë Akademike dhe Edukimit Mjekësor

# KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Fokus: "STROKU, faktorët e riskut dhe sfidat e trajtimit të tij"

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



## PROGRAMI SHKENCOR:

Moderatorë: Prof. Dr. Mentor Petrela, Prof. Asc. Zamir Ndroqi

### 15:00-15:25 - Aspekte epidemiologjike dhe infarktet cerebrale në moshat e reja

Prof. Asc. Zamir Ndroqi  
Përgjegjës i Shërbimit të Neurologjisë  
Comprehensiv and Trombectomy STROKE UNIT  
Center, Spitali Amerikan

### 15:25-15:50 - Trajtimi endovaskular i aneurizmave të rupturuara.

Dr. Shkc. Arben Rroji  
Mjekë Neuroradiologë pranë QSUT, Spitali Amerikan

### 15:50-16:10 - Trombektomia mekanike në trajtimin e infarktit iskemik

"Gold standart-art of medicine"  
Dr. Shkc. Eugen Enesi  
Mjekë Neuroradiologë pranë QSUT

### 16:10-16:35 - Trajtimi endovaskular në okluzionet akute të arteries bazilare.

Dr. Shkc. Fatmir Bilaj  
Mjekë Radiolog pranë QSUT

### 16:35-17:00 - Angioplastika me stentë e arterieve karotide dhe ndjekja me Eco doppler.

Dr. Klodian Çaçi  
Mjekë Neuroradiologë, Spitali Amerikan

### 17:00-17:20 - Terapia intensive tek pacientët me probleme neurovaskulare.

Dr. Gentian Huti  
Mjekë Anestezist, Spitali Amerikan

### 17:20-17:40 - Teknikat anestetike në procedurat neurovaskulare.

Prof. Asc. Rudin Domi  
Mjekë Anestezist, Spitali Amerikan

### 17:40-17:55- Organizimi dhe menaxhimi i STROKE UNIT.

Dr. Florian Vaso  
Menaxher i Shërbimit të Urgjencës, Spitali Amerikan

### 17:55-18:00 - Diskutime, Konkluzione

Kategoria e pjesëmarrësve: klinikistë, neurologë, anestezistë, kardiologë, radiologë, mjekë të përgjithshëm, kirurgë, farmacistë, dentistë, infermierë-mami, studentë të mjekësisë apo shkencave mjekësore, etj.

**Organizuar nga Shoqata AMEA – Albanian Medical Education Association**

## KOMITETI ORGANIZUES

**Klodian Allajbeu**  
Drejtor i Përgjithshëm  
Spitali Amerikan

**Lindita Shosha**  
Drejtoresh e Strategjisë Akademike  
dhe Edukimit Mjekësor

**Mario Karaj**  
Drejtor i Menaxhimit Spitalor  
Spitali Amerikan

**Onejda Ymeraj**  
Drejtoresh Operacionale  
Spitali Amerikan

## Sekretare Organizative

**Albana Mehmeti**  
Kordinatorë e Edukimit në Vazhdim

Email: [albana.mehmeti@spitaliamerikan.com](mailto:albana.mehmeti@spitaliamerikan.com)

Web: [www.imca.al](http://www.imca.al)

Mob: 0684032151



Prof. Dr. Mentor Petreia

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Prof. Asoc. Zamir Mëdroqi

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Prof. Asoc. Rudin Dami

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Gentian Huti

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Shkic. Arben Rroqi

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Klodian Capi

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI


Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Fatmir Bilaj

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI


Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Florian Vaso

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00



Dr. Shkic. Eugen Enesi

Albanian Medical Education Association | KONFERENCA MJEKËSORE NEUROLOGJI

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Prill 2019 | 15:00 - 18:00

**PO 16 Trajtimi endovascular i aneurizmave të ruptuara**

Rroji A., Enesi E., Bilaj F., Caca K., Huti G., Petrela M.

**Hyrje:** Aneurizmat sakulare janë forma më e shpeshtë e aneurizmave. Ato lokalizohen më shpesh në nivel të bifurkacioneve arteriale. Etiologjia dhe patofiziologjia e tyre është komplekse dhe pak e njohur. Përveç faktorëve gjenetikë edhe faktorë të tjerë si moshë, tensioni arterial dhe duhapirja mendohet se kontribuojnë në zhvillimin dhe rupturimin e aneurizmave. Mesatarja vjetore e riskut për HSA është 10 deri në 21 për 100 000 njerëz, me incidencën më të lartë në Finlandë dhe Japoni. Faktorë risku për hemorragji janë gjinia femërore, moshë, aneurizma simptomatike të mëparshme, dimensionët e mëdha dhe lokalizimi në qarkullimin posterior.

Prognoza e aneurizmave të ruptuara, të patrajuara është jo e mirë. Në një studim, mortaliteti para se pacienti të arrinte në spital ishte 12%, 43% në javën e parë dhe 56% në ditën e 30-të, nëse aneurizma nuk trajtohet. Në një meta-analizë të aneurizmave të patrajuara të realizuar nga Hero në 1990, mortaliteti dhe morbiditeti sinjifikativ pas hemorragjisë së parë u vlerësua 50%, me një mortalitet rreth 35% pas hemorragjisë së dytë. Risku për përsëritje të hemorragjisë është rreth 1% në ditë për 9 ditët e para, rritet me 4% në ditën e dhjetë dhe më pas luhet rreth 2-3% midis ditës 11-15. Risku kumulativ i përsëritjes së hemorragjisë është 20% në 2 javët e para dhe 30 deri në 50% në 6 muaj.

Aneurizmat në mënyrë karakteristike lokalizohen në nivel të degëzimeve arteriale. Kurse aneurizma të paretit të vazave, por jo në nivel të degëzimeve, janë të rralla dhe kryesisht të lokalizuara në nivel të përkuljeve arteriale në atë drejtim në të cilën do të rridhte gjaku, nëse arteria do të kishte dekurs linear. Në të dy rastet ka alterime lokale të hemodinamikës intravazale, të cilat ushtrojnë forcë në paretin vaskular. Rrjedhimisht kupola e aneurizmës ka drejtimin e forcës hemodinamike. Aneurizmat e lokalizuara në segmentët vazale të pa degëzuara ngrenë dyshimin për disekacion, pasi ky lokalizim është i rrallë. Më shumë se 90% e aneurizmave sakulare janë të lokalizuara në një nga pesë lokalizimet e mëposhtme:

1. A.carotis interne në nivel të origjinës së ACP;
2. Junksioni midis ACA dhe ACoA;
3. Bifurkacioni proksimal i ACM;
4. Bifurkacioni i A.Basilare në dy ACP;
5. Bifurkacioni i ACI në ACM dhe ACA.

Lokalizime të tjera të shpeshta të aneurizmave në qarkullimin anterior janë edhe origjina e a. oftalmike, a. hipofizale dhe choroidea. Në qarkullimin posterior janë origjina e arteries cerebellare postero-inferiore, antero-inferiore dhe junksioni i arteries basilare dhe vertebrale.

Për aneurizmat e ruptuara ka dy alternativa madhore trajtimi: klipimi neurokirurgjikal dhe trajtimi endovaskular me coil. Pas trajtimit endovaskular të parë në 1990, embolizimi fillimisht u përdor vetëm në rastet të cilat paraqisnin vështirësi në trajtimin kirurgjikal dhe për pacientë në gjendje të rëndë. Që prej publikimit të rezultatëve të International Subarachnoid Aneurysm Trial (ISAT), trajtimi endovaskular është bërë më i pranueshëm dhe konsiderohet në shumë qendra si teknika e preferuar për trajtimin e aneurizmave të ruptuara. ISAT demonstroi se pacientët me aneurizma të vlerësuar nga neurokirurgu dhe neuroradiologu intervencionues si kandidatë të terapive respektive patën rezultatë më të mira të morbiditetit, pavarësisht dhe mortalitetit kur iu nënshtruan trajtimit endovaskular. Sot në Spitalin Amerikan aplikohen me sukses të dy këto metoda. Në këtë prezantim do të paraqesim rastet e trajtuara nga ekipi endovaskular në një periudhë 2 vjeçare.

**PO 17 Trombektomia mekanike në trajtimin e infarktut iskemik -“Gold standard - art of medicine”- Historiku**

Enesi E.1, Rroji A.1, Bilaj F.1, Caci K.1, Ndroqi Z.2, Roci E.2, Domi R.4, Petrela M.3

**Hyrje:** Hipokrati (460 – 370 para Krishtit), i njohur si Babai i mjekësisë, e ka përshkruar insultin cerebral rreth 2400 vjet më parë “apoplexy”, që do të thotë “i goditur me dhunë” në greqishtën e vjetër. Kjo e lidhur me faktin e ngjashëm ku një person pësonte një paralizë të menjëhershme nga një gjendje e mirë shëndetësore. Kjo terminologji u përdor për një periudhë të gjatë si pasojë e njohurive të pakta neuroanatomike dhe neurovaskulare. Shkaqet e strotkut dhe mënyra e trajtimit ishin të panjohura deri në raportimin e angiografive të para pas shpikjes së Angiografisë Cerebrale nga Egas Moniz në 1927. Në këtë kohë apoplexia u nda në kategori bazuar në shkakun e problemit të arteries së gjakut. Më tej, përdorimi i terminologjisë “stroke” apo “Aksident Cerebro Vaskular(AVC)” iu referua “goditjes në tru” ose insultit cerebral si pasojë e pakësimit të furnizimit me gjak të trurit.

Termi “goditje në tru” ose “brain attack” sot përdoret si sensibilizim në popullatë për ndërmarrjen e veprimeve të shpejta dhe ndërhyrjet trajtuese urgjente.

Tromboliza intravenoze e çertifikuar sipas FDA në 1996, ndërsa në Europë në 2002 është një trajtim efektiv për AVC ishemiike. Megjithatë shkalla e rekanalizimit mbetet e ulët sidomos në okluzionet e vazave të mëdha. Nga ana tjetër Terapia Endovaskulare intra arteriale bën të mundur rekanalizimin vaskular me një shkallë më të lartë krahasuar me trombolizën intravenoze.

Për të mbështetur këtë teori janë publikuar në 2015 një sërë studimesh, të cilat vërtetuan superioritetin e terapisë intra-arteriale, duke e çertifikuar si “Gold Standard”- Art of medicine trombektominë mekanike në trajtimin e infarktut cerebral nga okluzioni i vazave të mëdha.

Fillimet e procedurave endovaskulare në vendin tonë datojnë në vitin 2011 me ardhjen e Prof. Emmanuel Houdart (Paris) dhe realizimin e embolizimit të aneurizmës intrakraniale në një paciente me stroke hemorragjik (HSA)

Ndërkohë që trombektomia e parë mekanike u realizua në Tiranë në Dhjetor 2013 duke sjellë për Shqipërinë një inovacion dhe duke standardizuar mjekimin e strotkut ishemiik në të njëjtin nivel me protokollet e vendeve të tjera të zhvilluara të Europës dhe USA, madje edhe përpara aplikimit të TPA në vendin tonë. Kjo risi i dha hov edhe zhvillim trajtimit të strotkut në Shqipëri si evolucion në shërbimin e Neurologjisë dhe revolucion në Shërbimin e Neuroradiologjisë. Ky standard në Shqipëri u pasqyrua me realizimin e tre konferencave të Strotkut (Stroke I, II dhe III) përkatësisht në 2015, 2016 dhe 2017 si

dhe një Simpoziumi të Neuroradiologjisë Intervencioniste në 2017 me pjesëmarrje ekspertësh nga qendrat më të mira evropiane. Së fundmi, është kontributi ynë në literaturë si pjesë e studimeve evropiane për zhvillimin e trajtimit të infarktut ishëmik në 44 shtete me eksperiencë disa vjeçare në stroke, studim i botuar në Maj 2018 në European Stroke Journal.

### **PO 18 Trajtimi endovaskular tek Okluzionet akute të arteries bazilare**

*Bilaj F.1, Rroji A.1, Enesi E.1, Caci K.1, Basha E.2, Avdyli A.4, Ndroqi N.2, Petrela M.3*

**Qëllimi:** Okluzioni akut i a.bazilare konsiderohet ndër situatat mjekësore më të rënda, me mortalitet dhe morbiditet shumë të lartë, që arrin deri në 95%. Qëllimi i këtij studimi është të prezantojë eksperiencën tonë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe Spitalin Amerikan 3, në trajtimin e pacientëve me okluzionë akutë të a.bazilare me anë të metodës së trajtimit endovaskular, dhe të vlerësojmë faktorët prognostikë që përmirësojnë të dhënat klinike të pacientëve dhe shkallën e rikanalizimit të a.bazilare.

**Metodat dhe materialet:** Ky është një studim retrospektiv që ka analizuar pacientët me okluzionë akutë të a.bazilare nga periudha 2013 deri tani. Janë 6 pacientë me okluzion akut të a.bazilare me moshë mesatare 56 vjeç që ju nënshtruan trajtimit endovaskular. U vlerësuan për çdo pacient të dhënat klinike, imazherike dhe ato gjatë procedurës endovaskulare. Shkalla e rikanalizimit u vlerësua në bazë të TICl score 0-3 (thrombolysis in cerebral infarction) dhe vlerësimi klinik u realizua në bazë të MRS 0-6 (the modified Rankin scale).

**Rezultatet:** 1 pacient nuk ariti të mbijetonte, kurse në 5 pacientë të tjerë u realizua rikanalizim i a.abazilare nëpërmjet thrombektomisë mekanike dhe angioplastikës së a.bazilare. Në 1 pacient u evidentua okluzion i porcionit distal të a.bazilare, kurse në 5 pacientë në porcionin e mesëm dhe proximal. Pacientët në vlerësimin neurologjik mbas 3 muajsh u klasifikuan sipas mRS 0-2. Shkalla e rikanalizimit ishte e plotë në të 5-të pacientët, TICl score 3. Korrelimi i mirë u evidentua midis shkallës së rikanalizimit dhe mRS score.

**Konkluzionet:** Trajtimi endovaskular është i mundshëm dhe efektiv në okluzionet akute të a.bazilare. Ky trajtim rezulton në shpëtimin e jetës së pacientëve dhe në përmirësim të ndjeshëm klinik.

Studimet prospektive në të ardhmen të tipit randomised -controlled trial dhe me popullata më të mëdha, do të ndihmojnë për të përcaktuar më mirë prognozën e pacientëve me okluzione akute të a.bazilare. Edukimi i komunitetit të gjerë mjekësor, rritja e ndërgjegjësimit të popullatës, vendosja e politikave stimuluese shëndetësore janë të nevojshme për të nxitur këto lloj trajtimesh që përkthehen në rezultate shumë të mira klinike për pacientët.

### **PO 19 Organizimi dhe menaxhimi i STROKE UNIT**

*Vaso F.*

**Hyrje:** Në këtë prezantim përshkruhen kriteret dhe kushtet e nevojshme për organizimin e Njësisë së STROKE në vendet e zhvilluara dhe në vendin tonë, si dhe sfidat për menaxhimin sa më efikas të këtij shërbimi kompleks. Analizohen elementët e nevojshëm përbërës për funksionimin e kësaj njësie, duke u ndalur në secilin prej tyre për të kuptuar më mirë specifikën dhe rëndësinë e tij. Arrihet në një vështrim të detajuar mbi burimet njerëzore dhe ekspertizës së tyre mjekësore, teknike dhe menaxheriale si aseti kryesor dhe më i rëndësishëm për ndërtimin e ekipit të STROKE UNIT. Konsideratë jepet mbi disiplinat dhe shërbimet e nevojshme mbështetëse për STROKE UNIT. Sistemi i koordinimit dhe organizimit të Shërbimit i urgjencës si faktori i parë përcaktues për kohën e aksesit të pacientit në trajtim. Rëndësia e njësisë së terapisë intensive/reanimacioni në suksesin e trajtimit dhe kapacitetet e nevojshme për të mbështetur këtë kategori pacientësh. Repartet e specializuara për stroke dhe organizimi i shërbimit të terapisë konservative. Radiologjia diagnostike jo invazive dhe telemjekësia si elementi thelbësor në sistemin e referencës. Shërbimet rehabilituese fizike dhe psikologjike dhe problematikat për akses nga popullata. Kriteret për infrastukturën dhe teknologjinë renditen bazuar sipas udhëzimeve të Organizatës Europiane të STROKE UNIT dhe mundësitë e zbatimit guideline në vendin tonë. Vendimarrja mbi kosot e përfutimit të këtij shërbimi në vende të varfëra si Shqipëria, gjendja aktuale në vendin tonë, roli i politikave shëndetësore dhe mekanizmat e tjerë me karakter teknik dhe ligjor në përmirësimin dhe zhvillimin e këtij shërbimi. Puna e bërë me Fushatat për sensibilizimin e popullatës dhe personelit mjekësor në të gjithë vendin. Sfidat e tashme dhe të së ardhmes, globale dhe lokale me të cilat përballlet menaxhimi i njësisë së STROKE UNIT. Një vështrim në të ardhmen, synimet dhe projektet për aksesin më të gjerë të popullatës në këto shërbime jetë shpëtuese.

**Metoda:** Në këtë punim bëhet krahasimi i organizimit dhe menaxhimit të STROKE UNIT në vendin tonë me udhëzuesit dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, duke synuar të nxjerrë në pah punën e kryer deri tani dhe sfidat kryesore për të ardhmen

**Rezultati:** Një pamje më e qartë e modelit të organizimit në vendin tonë të STROKE UNIT dhe përcaktimi i hapave me emergjent të rradhës për një nivel më të lartë dhe efikas shërbimi.

### **PO 20 Terapia intensive tek pacientët me probleme neurovaskulare**

*Huti G.*

**Hyrje:** Trajtimi i pacientëve me probleme cerebrovaskulare është kompleks dhe kërkon bashkëpunim multispecialistik. Kujdesi për këta pacientë në terapi intensive është vazhdim i kujdesit në sallë dhe konsiston në monitorizimin e ngushtë neurologjik, kujdesin për hemodinamikën, përdorimin ose jo të antikoagulantëve, dhe kujdesin e përgjithshëm si për çdo pacient të terapisë intensive. Minotorizmi i sferës neurologjike shërben për të parë se si shkojnë ndryshimet neurologjike ekzistuese dhe nëse ka apo jo defiqite të reja.

**Metoda:** Mjeku në terapi intensive duhet të këtë njohuri mbi teknikën anestetike, procedurën neurologjike të kryer, deficitet papaprake dhe sigurisht edhe prognozën e pacientit. Vlerësimi neurologjik bëhet çdo 2-4 orë dhe në rast përkeqësimi apo shfaqje të një defiqiti njoftohet ekipi i neurologji-neuroradiologji, si edhe mund të kërkohen ekzaminime imazherike shtesë. Kujdesi për hemodinamikën është shumë i rëndësishëm.

Në rastet e patologjive ishemike/trombectomive/stendeve në karotide, është e preferueshme të mbahen presione arteriale 140-180 mmHg. Në rastet e embolizimeve ose me rrezik të lartë ndaj hemorragjisë tentohen presione të ulta arteriale në rangun e 100-110 mmHg.

**Rezultati:** Vlen të theksohet se vlerat e përshkruara të presioneve vendosen edhe duke u bazuar mbi pacientin/procedurë/sëmundjet shoqëruese dhe në bashkëpunim të plotë midis specialistëve që janë të përfshirë. Trajtimi i lezioneve ishemike apo trombectomive si edhe vendosja e stendeve kërkon edhe përdorimin e antiagregantëve dhe/ose antikogulantëve. Kujdes i veçantë duhet treguar nëse është bërë paraprakisht tromboliza. Në kujdesin e përgjithshëm merr rëndësi parandalimi i ulçerave të stresit, aktivizimi sa më i shpejtë i pacientit, nutricioni, evitimi i dekubituseve, si edhe kujdesi për evitimin e komplikacioneve respiratore. Së fundi, duhet theksuar që puna në terapi intensive për këta të sëmurë përfshin një sërë specialitetesh, bashkëpunimi i ngushtë i të cilëve mund të përmirësojë ecurinë e pacientit.

### PO 21 Angioplastika me stente e arterieve karotide dhe ndjekja me Eco doppler.

*Caci K., Rroji A., Enesi E., Bilaj F., Arapi B., Qirinxhi D.*

**Hyrje:** Në këtë prezantim ju njohim me eksperiencën tonë me angioplastikën me stent të arterieve karotide dhe ndjekjen me eko Doppler dhe TCD në dinamike të stentit intrakarotidien.

**Materialet dhe metoda:** Një vlerësim retrospektiv i rasteve të trajtuara me angioplastikë me stent të arterieve karotide dhe patologjive të të semurëve pranë Departamentit tonë të Neuroradiologjisë Intervencionuese. Përdorim stent Casper me 2 shtresa, shtresa e brendshme e të cilit ka pore me diametër shumë të vogël që është një barrierë efikase ndaj kalimit të embolave. Gjithashtu, përdorim balon Maverick për predilatim dhe balon Ultrasoft për postdilatim të stentit. Në periudhën pre procedure (në rastet jo urgjente) zakonisht pacienti është trajtuar me plavix 75 mg 2x1 tab/ditë dhe aspirinë 100 mg/ditë për 1 javë. Më pas ka vazhduar me plavix 75 mg dhe aspirinë 100 mg /ditë për 6 muaj. Ndjekja në dinamike me Doppler ultrasound dhe TCD\* bëhet me aparat GE Logiq F6. Në kontrollin e stentit bëhen matje të kalibrit të stentit në pjesën proximale, të mesme dhe distale të stentit nëse është e mundur (në disa rastë pjesa distale e stentit është intrakranial), gjithashtu vlerësohet fluksi intrastent në color doppler dhe shpejtësitë sistolo-distolike. TCD e arterieve intrakraniale (kryesisht ACI dhe ACM) shton sigurinë diagnostike.

**Rezultati:** Deri tani në Departamentin tonë janë trajtuar 18 raste me stent karotidien. Prej tyre 14 raste kanë qenë stenoza të arterieve karotide dhe 4 raste kanë qenë në terren të diseksionit të arteries. Në periudhën e afërt post operatore nuk janë vënë re evente madhore iskemike apo hemorragjike të lidhura me vendosjen e stentit dhe trajtimin shoqërues.

Në ndjekjen në dinamike me eko doppler nuk janë vënë re okludime të stentit apo stenoza kritike (mbi 50%).

**Konkluzion:** Në eksperiencën tonë angioplastika me stent e arteries karotide është një metodë efikase dhe relativisht e sigurt për trajtimin e stenozave kritike të arterieve karotide. Edhe në rastin e diseksionit të ACI trajtimi me stent është një metodë që duhet të kihet në konsideratë në situatat akute dhe me treguesit neurologjikë të përkeqësuar. Ndjekja në dinamike me eko doppler dhe TCD\* është një metodë e besueshme, praktike, me kosto të lirë dhe e kudogjendshme.

TCD\* dopler transkranial.

### PO 22 Teknikat anestetike në procedurat neurovaskulare

*Domi R.*

**Hyrje:** Në ditët e sotme problemet cerebrovasculare janë shkak madhor për sëmundshmëri dhe vdekshmëri. Struktura e sëmundshmërisë në Shqipëri ka tre pika kryesore sot: onkologji, sëmundje cerebrovasculare dhe sëmundje kardiovaskulare. Çdo anestezi do të përballet me pacientë cerebrovasculare. Trajtimi endoskopik i tyre përfshin trombektomitë, embolizimet dhe stendet në karotide. Duke qenë procedura delikate duan ekip multidisciplinor si: neurologë, neurokirurgë, anestezi të reanimatorë, neuroradiologë intervencionistë etj. Trombektomia mund të bëhet me anestezi gjenerale, sidomos kur bllokohet qarku posterior, por edhe me sedacion tek pacientët e qetë dhe bashkëpunues.

Kur është e nevojshme, ekipi i dedikuar i kujdesit neuro-intensiv, ofron kujdes të sofistikuar kritik në këta pacientë. Qendra jonë dhe STROKE Unit përdor teknikat e fundit të monitorimit të multimodalitetit për t'u kujdesur për pacientët me lëndime të rënda neurologjike. Këtu futen në funksion të gjitha ekipet e mësipërme:

- Presioni arterial mendohet të jetë në shifrat 140-180 mmHg për furnizimin adekuat të trurit.
- Procedurat embolizuese janë mjaft të rëndësishme dhe delikate.
- Anestezia e preferuar është ajo gjenerale dhe me hypotension të induktuar duke evituar çdo rritje të presionit arterial të papritur për të evituar plasjen aksidentale të aneurizmës.
- Gjatë manipulimit mund të kemi bradikardi dhe hypertension reflektiv, migrim të substancës sklerotizuese, si edhe emboli nga hyrja në qarkullim e tyre me të gjitha pasojat e mundshme deri në arrest.
- Stendet në karotide realizohen me sedacion ose anestezi lokale, nën trajtimin me antiagregantë dhe në monitorizim të ngushtë perioperator. Është njësi më e avancuar teknologjike dhe e sofistikuar e kujdesit neuro-kritik në vend dhe është i vetmi institucion akademik i këtij lloji në rajon. Suksesin e këtyre procedurave e garanton vetëm bashkëpunimi midis neurologut, anesteziatit, neuroradiologut intervencionues, si dhe komunikimi i shpejtë midis hallkave të një zinxhiri mjekësor dhe profesional.

### PO 23 Aspekte epidemiologjike dhe Infarkt cerebrale tek moshat e reja

*Ndroqi Z.1, Karame E.1*

**Hyrje:** STROKE janë ndër problemet më të rëndësishme të shëndetit publik, problem i madh global dhe ekonomik. Ato zënë vendin e parë në invadilitetin e përgjithshëm dhe në vendet në zhvillim zënë vendin e dytë në vdekshmërinë e përgjithshme (në të parën janë sëmundjet e zemrës, në të dytën STROKE dhe pas vijnë tumoret, aksidentet, sëmundjet e mush-



kërive etj.). Ndërsa në vendet e zhvilluara, në sajë të masave të gjithanshme të organizuara mjekësore dhe sociale, vdekshmëria ka rënë në vendin e katërt apo të pestë. Në këtë kuadër edhe adoleshentët janë të prekur nga sëmundja cerebrovasculare, megjithëse frekuenca e vdekjes nga STROKE është më e ulët se në pacientët me STROKE në popullsinë e përgjithshme. Por, STROKE është veçanërisht dramatike tek pacientët e rinj, sepse prek pacientët që më parë ishin të shëndoshë dhe, gjithashtu, lë pasojë serioze për gjatë gjithë jetës. Shpenzimet (buxheti) është shumë më i kushtueshëm për adultët e rinj, si për familjen dhe shoqërinë. Sëmundjet cerebrovaskulare në adultët e rinj përbëjnë 5-10% të rasteve me STROKE dhe mbeten një nga 10 shkaqet kryesore të vdekjeve në këto moshë. Ato paraqesin shpesh një sfidë diagnostike dhe terapeutike për klinikistët me një kohë mesatare njohje prej 35.7 orësh për pacientët e rinj. Megjithë progresin e njohurive, shpesh shkaqet e sëmundjes mund të mbeten të papërcaktuara dhe me një varietet të gjerë të problemeve diagnostike dhe etiologjike (Tabela 1). Ka diferenca të shënuara si në incidence, klinike, faktorë risku dhe prognoze midis STROKE që ndodh në moshën nga 45 vjeç e poshtë, dhe në individet mbi 45 vjeç. Raportet e regjistrimit të STROKE të Lozanës dhe Brukselit kanë treguar se 13.5% dhe 11.4% të pacientëve me STROKE për herë të parë ishin jo më tepër se 45 vjeçë. Në vendet në zhvillim ky proporcion është edhe më i lartë me 19-30% të STROKE. Incidenca e STROKE në adultët e rinj është në rritje vitet e fundit edhe në vendet me të ardhura të larta, në disa studime përbën 10-15% të STROKE (me një rritje + 43.8%, dhe rritje të lehtë + 4.7% në moshat 45-64 vjeç, ndërsa me një ulje të shënuar - 28.5% në moshat 65-84 vjeç dhe me -22.1% mbi 85 vjeç) - sipas RAMIRES JAHA 2016. Ka një boshllëk të njohurive për tendencat në vendet me të ardhura të ulëta ose mesatare. Arsyet e kësaj tendence rritjeje janë të shumta, duke filluar nga diagnostikimi më i mirë, në rritjen e prevalencës së faktorëve kërcënues në adultët e rinj si të diabetit mellitus, hiperkolesterolemisë, obezitetit, duhanit, alkoolit, drogave, ndotjet e ajrit, modifikimin e stilit të jetës. Në një studim tonin më 2013, në 584 raste të shtruar me STROKE (14% hemoragjik), 5.47% ishin nën moshën 45 vjeç. Megjithë përparimin e mjeteve diagnostike intensive, shkak i STROKE ishëmik mbetet i papërcaktuar në rreth 1/3 në moshat e reja. Madje, ky proporcion më i madh tek pacientët shumë të rinj. STROKE kriptogjenik llogaritet së paku në gjysmën e rasteve me moshë më pak se 30 vjeç, gjë që kërkon studime të mëtejshme për specificitetin dhe fispatologjinë e STROKE-ve të padeterminuar.

**Qëllimi:** Qëllimi i studimit është për të vënë në pah problemet e veçanta të STROKE në moshat e reja si të frekuencës, të faktorëve kërcënues, të simptomatikës, të topikës, të tipeve të tyre dhe gravitetit e prognozës.

**Metoda:** Studim retrospektiv i rreth 15 rasteve të shtruar në Spitalin Amerikan 3 dhe të paraqitura në Poliklinikë nga Janari 2017 deri tani me infarkte në moshë nga 18-49 vjeç. U analizuan të dhënat demografike (mosha, seksi, origjina urbane apo rurale, faktorët ekologjikë e kërcënues (HTA e moshë e trajtimi i tij, sëmundjet koronare, të muskullit të zemrës, aritmitë e FA, sëmundjet valvulare, DM, dislipidemia, obeziteti, duhani, alkooli, drogat, historiku familjar për STROKE, trauma, etj.). U studiuan shkaqet e mundshme të STROKE. U evidentuan rrethanat e shfaqjes së STROKE. U shqyrtuan shenjat klinike dhe u përcaktuan subtipet e STROKE (tromboza, emboli, hemodinamika, lacuna), si dhe topika e lezioneve. U studiuan lezionet vaskulare përgjegjëse dhe graviteti i STROKE.

**Diskutime:** STROKE në moshat e reja ka veçoritë me ato të moshave mbi 50 vjeç për arsye të faktorëve kërcënues, të etiologjive dhe të shpeshtësisë më të madhe me faktorë risku të pa modifikueshëm që është moshë. Diskutimet janë që nga kufiri konvencional për STROKE- un e moshave të reja, që përgjithësisht studiohet nga më të rinj se 50 vjeç, por dhe në mjaft studime edhe më të rinj se 45 vjeç. Studimet e ndryshme epidemiologjike japin disa shifra, por është i vështirë krahasimi midis tyre si për metodologjinë, moshën, kriteret diagnostike, kohën e ndjekjes dhe ndryshimet patologjike. Ato ndryshojnë nga një vend në tjetrin nga nën 5% deri 20% të të gjithë STROKE. Ne i kemi hasur në 15 raste nga Janari 2017 deri tani me X raste STROKE, numër ky i vogël, por na jep të dhëna të vlefshme për larminë etiologjike në këtë moshë.

U vërejtën këto shkaqe: Në 3 dekadat e fundit janë publikuar një numër i gjerë studimesh për incidencën e STROKE në moshat e reja si MARINI që analizoi 29 studime me 3598 pacientë nën 45 vjeç me një incidencë 6.14% për 100.000 banorë deri 48.5% për 100.000 banorë (me stroke ishëmik 21% dhe 77.9% hemoragji cerebrale 3.7% dhe 38.5% e hemoragji subaraknoidale me 9.6% dhe 55.4%). Në një studim nga Bosnie-Herzegovina - STROKE ishëmik midis adultëve të rinj ishte 61% të rasteve, hemoragji intracerebrale 17% dhe hemoragji subaraknoidale 22%. Në një studim në Finlandë 2009 në moshat 15-49 vjeç incidenca vjetore ishte 10.8 për 100.000 banorë, duke u rritur eksponencialisht me moshën. GROppo jepte incidencën e STROKE me 12.1 raste për 100.000 banorë në italianët e rinj në 2012. Faktorët e rrezikut të modifikueshëm janë të njëjtë për të dy grupmoshat nën dhe mbi 50 vjeç, por prevalenca nuk është e njëjtë. HTA, sëmundjet e zemrës përfshirë AF, DM janë faktorët e riskut më të zakonshëm ndër të vjetrit, ndërsa në studimin finlandez tek të rinjtë faktorët e riskut vaskular e të zakonshëm ishin dislipidemia 60%, duhanpirja 44%, HTA 39%. Në rastet tona faktorët e rrezikut ishin me tepër HTA, dislipidemia, obeziteti, duhanpirja. Shtimi i faktorëve të riskut rëndon prognozën dhe mortalitetin edhe në adultët e rinj. Në shkaqet etiologjike janë më të shpeshta atheroskleroza e vazave të mëdha, kardioembolizmi, sëmundja e vazave të vogla dhe diseksione arteriale cerviko cefalike, pastaj vijnë shkaqet jo të zakonshme të STROKE –ut si displazia fibromuskulare, migrena etj. Diskutimet e tjera më të hollësishme do të bëhen pas rezultateve të studimit dhe paraqitjes së materialit.

**Konkluzione:** Faktorët e rrezikut më frekuentë për STROKE në grupmoshat 18-49 vjeç ishin HTA, hiperlipidemia, obeziteti, duhanpirja, diabeti mellitus e historia familjare për STROKE. Si shkaqe më të shpeshta ishin arteriopati si atherosklerotike dhe me pak ato jo atherosklerotike, rrallë inflamatore. Shkak i shpeshtë u vërejtën kardiopati emboligjene, si dhe diseksionet (me tepër traumatike). U konstatuan edhe shkaqe të rralla të STROKE. Në pak raste nuk u përcaktua etiologjia. Pacientët e rinj me STROKE kanë vdekshmëri më të lartë, invaliditet dhe paafësi në punë të zgjatur me shpenzime të mëdha për familjen dhe shoqërinë. Të gjitha këto të dhëna nga literatura dhe eksperiencat tona sugjerojnë organizimin më të mirë të profilaksisë, të edukimit e informimit të të rinjve, të preventimit vaskular primar, të faktorëve kërcënues si të HTA-së, sëmundjeve të zemrës, të aksidenteve e traumave dhe të faktorëve të tjerë kërcënues vaskularë, të stilit të jetës të duhanit, alkoolit dhe drogave, me qëllim për të ulur frekuencën e viktimave të këtyre dramave të të rinjve, të cilat kanë një kosto shumë të lartë social-ekonomike për jetën, familjen dhe shoqërinë. Organizimi i ndihmës së parë intensive kur ndodhin këto goditje vaskulare të trurit, nëpërmjet COMPREHENSIV AND TROMBEKTOMI STROKE CENTER (të cilën ne e kemi jetësuar) me trombolizë, trombektomi e interverte neurokirurgjikale e neuroradiologjike bashkëkohore, është shpëtimtare e jetës së këtyre të rinjve.

# Konferenca Mjekësore Kardiologjisë

**Fokus: “Emergjencat kardiake, diagnoza  
dhe trajtimi optimal i tyre”**

Salla e Konferencave,  
Spitali Amerikan 3, Tiranë  
30 Maj 2019 / 15:00-18:00

## PROGRAMI SHKENCOR:

Moderatore: Dr. Shkc. Nereida Xhabija

15:00-15:25

### Urgjencat Kardiake koronare.

Dr. Shkc. Nereida Xhabija,  
Kardiologe, Spitali Amerikan.



15:25-15:50

### Ruptura post-infarktuale e septumit interventrikular.

Dr. Maksim Llambro, Kardiolog Intervencionist,  
Shef i Departamentit të Kardiologjisë, Spitali Hygeia



15:50-16:15

### Urgjencat kardio-kirurgjikale.

Dr. Arben Kojqigji, Kardiokirurg torakal,  
Shef i Departamentit të Kardiokirurgjisë,  
Spitali Amerikan



16:15-16:40

### Sindromet Aortike Akute, diagnoza dhe trajtimi i tyre.

Dr. Elona Dado, Kardiologe, Spitali Hygeia



16:40-17:05

### Sinkopi dhe Aritmitë kardiake në Departamentin e Urgjencës.

Dr. Indrit Temali, Kardiolog, Spitali Amerikan



17:05-17:30

### Insuficienca kardiake-akute, diagnoza dhe trajtimi i saj.

Dr. Fatmir Sula, Kardiolog, Spitali Amerikan



17:30-17:55

### Menaxhimi në Urgjencë i Krizës Hipertensive.

Dr. Almenda Zaka, Mjeko Urgjence,  
Spitali Amerikan



17:55-18:00

Diskutime, Konkluzione

## Organizuar nga Shoqata AMEA – Albanian Medical Education Association

Kategoria e pjesëmarrësve: Klinikistë, kardiologë, mjekë urgjence, radiologë, kirurgë,  
anestezistë, mjekë familjeje, mjekë të përgjithshëm, infermierë-mami,  
studentë të mjekësisë apo të shkencave mjekësore, etj.

### KOMITETI ORGANIZUES

**Klodian Allajbeu**  
Drejtor i Përgjithshëm  
Spitali Amerikan

**Lindita Shosha**  
Drejtoresh e Strategjisë Akademike  
dhe Edukimit Mjekësor

**Mario Karaj**  
Drejtor i Menaxhimit Spitalor  
Spitali Amerikan

**Onejda Ymeraj**  
Drejtoresh Operacionale  
Spitali Amerikan

### Sekretare Organizative

**Albana Mehmeti**  
Koordinator e Edukimit në Vazhdim

Email: [albana.mehmeti@spitaliamerikan.com](mailto:albana.mehmeti@spitaliamerikan.com)

Web: [www.imca.al](http://www.imca.al)

Mob: 0684032151



Albanian Medical Education Association

**Dr. Nereida Xhabija** Konferenca Mjekesore e Kardiologjise

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tirane 30 Maj 2019 / 15:00-18:00



Albanian Medical Education Association

**Dr. Indrit Temali** Konferenca Mjekesore e Kardiologjise

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tirane 30 Maj 2019 / 15:00-18:00



Albanian Medical Education Association

**Dr. Almenda Zaka** Konferenca Mjekesore e Kardiologjise

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tirane 30 Maj 2019 / 15:00-18:00



Albanian Medical Education Association

**Dr. Arben Kojqilq** Konferenca Mjekesore e Kardiologjise

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tirane 30 Maj 2019 / 15:00-18:00



Albanian Medical Education Association

**Dr. Fatmir Sula** Konferenca Mjekesore e Kardiologjise

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tirane 30 Maj 2019 / 15:00-18:00



Albanian Medical Education Association

**Dr. Elona Dado** Konferenca Mjekesore e Kardiologjise

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tirane 30 Maj 2019 / 15:00-18:00



Albanian Medical Education Association

**Dr. Maksim Llambro** Konferenca Mjekesore e Kardiologjise

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tirane 30 Maj 2019 / 15:00-18:00

## PO 24 Menaxhimi në Urgjencë i Krizës Hipertensive

Zaka A.

**Hyrja:** Prezantimi në Urgjencë i një pacienti me krizë hipertensive kërkon vlerësim të menjëhershëm, njohjen e masave që duhen marrë për trajtimin e hipertensionit dhe parandalimin e dëmtimeve të mundshme në organet target.

Në përgjithësi, Urgjencat hipertensive janë të lidhura ngushtë me presionin e gjakut pa evidencë të disfunkcionimit të organeve target. Megjithatë, ato mund të komplikohen edhe me keqfunksionim të organeve target si ishemia koronare, disekacion të aortës, encefalopati hipertensive, aksidentet cerebro-vaskulare, edema pulmonare, insuficiencia renale etj.

Pikërisht, për këtë arsye, nevojitet një vlerësim i saktë dhe i menjëhershëm i gjendjes klinike të pacientit, përcaktim i një etiologjie të mundshme të hipertensionit, shkalla e dëmtimit organor dhe zgjedhja e strategjisë së mjekimit.

Kriza hipertensive, zakonisht, menaxhohet me medikamente intravenoze dhe/ose orale, të cilat mund të fillohen menjëherë në urgjencë dhe pastaj vazhdon ndjekja nga 24 orë deri disa ditë në pavion, aty ku është i mundur monitorimi i vazhdueshëm i presionit të gjakut dhe komplanca me terapinë antihipertensive të zgjedhur nga mjeku specialist kardiolog, në varësi të karakteristikave të pacientit.

**Metodologjia:** Tema është bazuar në të gjithë pacientët e paraqitur në Urgjencën e Spitalit Amerikan. Kriteri i përdorur për përkufizimin e hipertensionit është ai i Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (presioni arterial sistolik > 139 mmHg dhe presioni arterial diastolik > 89 mmHg). Janë marrë në konsideratë të gjithë pacientët e paraqitur me hipertension, si pacientët që njihen si hipertensivë dhe pacientet që diagnostikohen për herë të parë.

**Rezultatet:** Numri i urgjencave hipertensive është gjithmonë në rritje. Gjithashtu, është në rritje numri i pacientëve që paraqiten në urgjencë me krizë hipertensive dhe nuk njihen si hipertensive.

**Konkluzionet:** Urgjencat hipertensive përbëjnë një numër të madh të urgjencave në përgjithësi. Pjesa më e madhe e pacientëve me krizë hipertensive kanë të paktën një organ të dëmtuar nga hipertensionin.

## PO 25 Urgjencat kardiokirurgjikale

Kojqiqi A.

**Hyrje:** Urgjencat kardiokirurgjikale ndahen në tri kategori të rëndësishme: Traumata kardiake, Disekacioni i Aortës dhe Kirurgjia e infarktut akut të miokardit. Rëndësi e veçantë i kushtohet përshkrimit të hollësishëm të prezantimit të pacientit me këto problematika, sidomos në rastet kur prezantimi klinik është jo i qartë dhe që vështirëson trajtimin e pacientit.

Rëndësia e secilës nga seksionet qëndron në dhënjen e njohurive të mjaftueshme, mjekut reanimator, në diagnostikimin sa më të hershëm të urgjencave kirurgjikale kardiake dhe në trajnimin e tij me një plan racional në mënyrë që trajtimi i këtyre pacientëve të jetë i menjëhershëm dhe i suksesshëm. Domosdoshmëria e ekzistencës së një ekipi të kualifikuar, i cili përfshin mjekë të licensuar, specialistë dhe infermierë të trajnuar mirë, çon në arritjen e rezultateve të mira në trajtimin e këtyre pacientëve.

Traumata kardiake.

Ruptura traumatike e aortës

Rupturat traumatike të aortës janë shkaktari i dytë vdekjeprurës nga aksidentet automobilistike dhe përbëjnë afërsisht 15% të të gjitha vdekshmërive të shkaktuara nga këto aksidente. Në 70-90% të rasteve vdekja ndodh në vendin e aksidentit. Afërsisht 8% e të aksidentuarve mbijetojnë 4h. Sipas disa raporteve të bëra publike, 48% e pacientëve kanë dhe trauma të tjera në zemër. Shumica e të dhënave janë të marra gjatë autopsisë së këtyre pacientëve. Diagnostikimi dhe trajtimi i këtyre pacientëve përbën një emergjencë të madhe. Trajtimi konsiston në zëvendësimin e aortës së shkëputur me tub dacroni.

Traumata e miokardit: Janë më të rralla edhe këto të shkaktuara nga aksidentet në trafik. Konsistojnë në hematoma të miokardit, por edhe në çarje të arterieve koronare, sidomos asaj anteriore ascendente të majtë. Kjo përbën urgjencë kardiake, pasi që tamponada kardiake e shkaktuar nga çarja e arteries koronare, çon në vdekjen e shpejtë të pacientit.

Disekacioni i aortës: Është një nga emergjencat kardiake kirurgjikale më kryesore dhe me një

vdekshmëri shumë të lartë, në rast të mos ndërhyrjes emergjente. Konsiston në çarjen e mureve të brendshme të aortës, të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm etiologjike. Vdekshmëria nga çarja e aortës është 1% në çdo orë vonesë. Trajtimi konsiston në zëvendësimin e aortës ascendente dhe harkut të aortës. Në rastin e disekacionit të aortës descendente, trajtimi konsiston në vendosjen e stentave aortal.

## PO 26 Sindromet Aortike Akute, diagnoza dhe trajtimi i tyre

*Dado E.*

**Hyrje:** Sindromat aortike akute (SAA) përfaqësojnë një nga urgjencat mjekësore më sfiduese, e lidhur kjo me larmishmërinë e shfaqjeve klinike, mortalitetin e lartë sidomos në orët e para, si edhe kompleksitetin dhe kualitetin e zgjidhjeve terapeutike.

Shfaqjet e ndryshme klinike të SAA mbështeten kryesisht në dëmtimin e intimas dhe medias, ku spikas: ndarja e shtresave të Ao (aortic dissection) deri në çarje të saj, hematoma brenda murit, ulçera depërtuese.

**Metoda:** Diagnoza e SAA mund të arrihet me të njëjtën saktësi nëpërmjet teknikave të ndryshme imazherike, të cilat shpesh herë përdoren në mënyrë plotësuese, për të marrë një tablo të plotë të rëndësës së rastit.

Ekokardiograma ka përparësinë e përdorimit në çdo njësi spitalore: urgjence, njësi intensive, sallë kirurgjikale, pa nevojën e transferimit të sëmurit, i cili është shpesh në gjendje kritike, me paqëndrueshmëri hemodinamike me përdorim barnash intra vene dhe i monitoruar. Gjithashtu, ky ekzaminim ka rolin e pazëvendësueshëm të vlerësimit morfologjik dhe funksional të valvulës së Aortës, një e dhënë fundamentale që përcakton llojin e ndërhyrjes kardiokirurgjikale

Rezultati: Në SAA përfshihen dhe dy dëmtime të tjera: Dëmtimi traumatik i Ao dhe aneurizma falls e Ao. Për shkak të origjinës së kësaj të fundit, kryesisht pas ndërhyrjeve të kryera pikërisht për korrigjimin e sëmundjeve të Ao, ky dëmtim diskutohet në kontekstin e ndjekjes pas ndërhyrjes.

SAA paraqesin një vdekshmëri shumë të lartë, prandaj diagnostikimi dhe trajtimi i hershëm, në varësi të indikacioneve, është vendimtar.

## PO 27 Insuficenca kardiake akute - Diagnoza dhe trajtimi në Shërbimin e Urgjencës

*Sula F.*

**Qëllimi:** Kjo përmbledhje do të fokusohet në paraqitjen e të dhënave të reja në diagnozën dhe trajtimin e Insufiçencës kardiake akute në Shërbimin e Urgjencës.

Insufiçenca kardiake akute është një problem madhor i shëndetësisë në ditët e sotme. Më shumë se 1 milion raste të reja në vit diagnostikohen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Insufiçenca kardiake është një sëmundje me kosto të lartë në diagnostikimin, shtrimin, trajtimin dhe ndjekjen ambulatorë e të sëmurëve që sipas studimeve pritet të shkojë në 2030 në 70 Bilion dollarë në vit. Gjithashtu, kjo sëmundje ka një mortalitet shumë të lartë deri 40% pas 5 vitesh, gjë që e krahason atë me kancerin bronkopulmonar dhe e fut atë në sëmundjet kanceroze dhe ka një përqindje të lartë të rishtrimeve, Rreth 50 % e pacientëve rishtrohen brenda 6 mujorit të parë pas shtrimit të parë. Kostoja e lartë, mortaliteti i lartë si dhe përqindja e lartë e rishtrimeve të insufiçencës kardiake akute, kanë çuar në miratimin e udhëzuesve të rinj për diagnozën dhe trajtimin e insufiçencës kardiake akute, në mënyrë që të ulet sa më shumë rishtrimet dhe mortaliteti i saj.

Futja e markueseve biokimik si BNP dhe NT pro BNP për diagnozën e insufiçencës kardiake akute si dhe echos pulmonare janë disa nga të dhënat e reja që paraqiten në këtë përmbledhje të guideline-ve botërorë të diagnozës dhe trajtimit të insufiçencës kardiake akute.

Po kështu, në trajtimin e Insufiçencës kardiake akute kanë ndryshuar shumë qëndrimet ndaj saj, duke u bazuar në sisteme pikëzimi të ndryshme për të përcaktuar shkallën e rrezikut që paraqet te pacienti me insufiçencë kardiake, me qëllim që të trajtohet që në urgjencë pa u shtruar në spital dhe të dalë në shtëpi direkt nga urgjenca me mjekim ambulator.

Po kështu, është modernizuar shumë ndjekja e të sëmurëve me insufiçencë kardiake (monitorimi në

distancë) në kushte shtëpie për të parandaluar përkeqësimin e insufiçencës kardiake, duke ulur rastet e rishtrimeve.

Në këtë paraqitje jepen në mënyrë të përmbledhur diagnoza dhe trajtimi i insufiçencës kardiake akute në urgjencë, si edhe disa metoda të reja të ndjekjes së të sëmurëve në kushte shtëpie.

Konkluzioni: Menaxhimi i insufiçencën kardiake akute në shërbimin e urgjencës përfshin diagnozën klinike, metodat diagnostike bashkëkohore dhe trajtimin sa me të shpejtë të saj në mënyrë sa më efikase.

## **PO 28 Sinkopi dhe Aritmitë kardiake në Departamentin e Urgjencës**

*Temali I.*

**Hyrje:** Aritmitë janë prevalente tek njerëzit e të gjitha moshave dhe mund të ndodhin në kuadër të një sëmundjeje kardiake, por edhe në një zemër me strukturë normale.

Ato përbëjnë një numër të rëndësishëm të pacientëve që paraqiten në Departamentin e Urgjencës. Aritmitë kanë një spektër të gjerë prezantimi klinik, por 3 janë mekanizmat kryesore të tyre: automaticiteti, triggered activity dhe re-entry.

**Metoda:** Kuptimi i mekanizmit të veprimit ndonëse jo i lehtë ndihmon në menaxhimin specific të aritmive të veçanta. Prezantimi ka për qëllim të japë këshilla të sakta në lidhje me diagnozën diferenciale dhe menaxhimin e pacientëve që vijnë në Urgjencë me Sinkop ose Aritmi, duke përfshirë Bradiaritmitë, Fibrilacionin atrial, Takikardite me komplekse QRS të ngushta dhe të gjera, duke u bazuar në guideline-t e EHRA.

**Diskutim:** Po kështu, këshilla por edhe algoritme do jepen për menaxhimin e pacientëve me keqfunktionim të pajisjeve të implantuara kardiake, stuhi elektrike dhe nevojën për kirurgji urgjente.

Gjithashtu, sugjerime jepen dhe kur duhet hospitalizuar i sëmuri me problemet e mësipërme.

## **PO 29 Ruptura post-infarktuale e septumit interventrikular**

*Llambro M.*

**Hyrje:** Ruptura e septumit interventrikular është një komplikacion mekanik i rrallë i infarktut akut të miokardit dhe potencialisht vdekjeprurës. Përpara futjes në praktiken klinike të teknikave moderne ripperfuzive, paraqitej në mënyrë tipike pas javës së parë të infarktut mesatarisht dita 3-5 (1). Mortaliteti i kësaj patologjie ngelet ende sot shumë i lartë.

Faktorët më të shpeshtë të shoqëruar me rupturën e septumit përfshijnë hipertensionin arterial, moshën > 70 vjeç, seksi femër, infarkti anterior dhe sëmundjen koronare monovazale.

Në kushte normale septumi furnizohet me gjak në 2/3 anteriore nga degët perforante të koronares discendente anteriore, ndërsa e treta posteriore furnizohet nga dega discendente posteriore. Një rrjet i gjerë anastomozash lidh këto dy arterie me njëra-tjetrën dhe është me e shprehur tek pacientët me sëmundje koronare multivazale, në të cilët zhvillohen cirkuj kolateral.

Nekroza e shtrirë septale është rezultat i ndërprerjes së papritur të fluksit koronar në mungesë të një cirkuli kolateral. Kjo shpjegon përse ruptura e septumit është më e shpeshtë tek pacientët pa histori kardiopatie ishemike dhe manifestohet në episodin e parë infarktual (2).

Kuadri klinik i rupturës së septumit interventrikular post-infarktual karakterizohet nga shfaqja de novo e një zhurme kardiake dhe e shoqëruar me grada të ndryshme të kompromentimit hemodinamik, e shkaktuar nga shunti majtas-djathtas. Shunti shkaktonte mbingarkesë të ventrikulit të djathtë dhe hiperfluks pulmonar dhe me përkeqësim progresiv të funksionit biventrikular deri në gjendje shock-u.

**Metoda:** Trajtimi konsiston në stabilizimin e pacientit me diuretikë, inotrope dhe eventualisht nëpërmjet përdorimit të balonit intra-aortik në pritje të trajtimit kirurgjikal.

**Rezultati:** Mbyllja perkutane paraqet një alternative efikase tek pacientët me shunt residual pas korrigit kirurgjikal dhe tek ata me rupturë kronike (3).

## **PO 30 Urgjencat kardiake koronare**

*Xhabija N.*

**Hyrje:** Prania e aterosklerozës është shkak kryesor që shkaktonte Sëmundjen e Arterieve Koronare. Kjo sëmundje, me evolucion progresiv dhe shpesh tinzar, mund të shkaktojë disa situata klinike emerg-

jente, ku rrezikohet jeta e pacientit dhe ku marrja e vendimeve të duhura në një kohë të shkurtër është çelësi i suksesit. Prandaj, njohja dhe diagnostikimi i Sindromës Koronare Akute, që si term përfshin gjithë urgjencat me origjinë koronare, përbën një sfidë për çdo ekip mjekësor në Urgjencë dhe në Departamentin e Kardiologjisë.

**Qëllimi:** Kjo Review do të fokusohet në një përditësim mbi menaxhimin e urgjencave koronare, në bazë të udhërrëfyesve të fundit të Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC), me qëllim që të bëhet triazhimi optimal i Sindromës Koronare Akute (SKA).

**Metodologjia:** Termi Sindromi Koronar Akut është një term i përgjithshëm ku përfshihen të pakten tre situata klinike të grupuara në të: Angina Pectoris e Paqëndrueshme (APP), Infarkti i Miokardit pa ngritje të ST (NSTEMI), dhe Infarkti i miokardit me ngritje të ST (STEMI). Këto tre entitete janë shpesh të vështira të dallohen, duke u bazuar vetëm në simptomat klinike. Elektrokardiografia (EKG) si dhe testet laboratorike janë mjete shumë të rëndësishme diagnostike, të cilat përdoren fillimisht.

Në varësi të këtyre rezultateve dhe monitorimit progresiv të tyre merret vendimi për të vazhduar me procedurat invazive të tilla si koronarografia dhe revaskularizimi me stente.

Koronarografia duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur në STEMI dhe në mënyrë efektive brenda (2–72 h) në NSTEMI. Kjo e pasuar edhe me procedura të tjera revaskularizuese, të cilat duhet të behen në një kohë sa më të shkurtër, për arsye se koha është e barazvlefshme me humbjen ose jo të muskulit kardiak .

Në këtë prezantim do paraqesim problematikat që hasen përpara një emergjence me etiologji koronare, që nga simptomatika e larmishme e deri trajtimi kompleks i tyre.

**Konkluzion:** Infarkti i Miokardit, si emergjenca madhore më e shpeshtë në praktikën mjekësore, duhet trajtuar në mënyrë invazive sa më shpejt që të jetë e mundur (90-120 min nga momenti i prezantimit), dhe pse jo po që e mundur edhe brenda asaj që quhet “golden hour”, në mënyrë që të shmangen pasojat e parikthyeshme, sepse siç dihet nga mjekët  $time=muscle$ .



# Konferenca Mjekësore Endokrinologji

“Diabeti 2019: Risitë e fundit në trajtimin e tij”

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë

27 Qershor 2019 / 15:00-18:00



## PROGRAMI SHKENCOR:

Moderatore: Dr. Shk. Entela Puca

15:00-15:20

Të dhëna epidemiologjike, llojet dhe diagnostikimi i diabetit.  
Prof. Ass. Thanas Fureraj,  
Endokrinolog, Spitali Hygeia



16:35-16:55

Diabeti i shtatzënise – kritere të ekzaminimit dhe diagnostikimit.  
Dr. Etleva Gjoshe,  
Endokrinologe, Spitali Amerikan



15:20-15:40

Strategjitë e reja terapeutike për menaxhimin e Diabetit Mellitus tip 2.  
Dr. Shk. Entela Puca,  
Endokrinologe, Spitali Amerikan



16:55-17:15

Risitë në trajtimin e Retinopatisë diabetike.  
Dr. Teuta Haveri,  
Oftalmologe, Spitali Amerikan



15:40-16:00

Si ka ndikuar teknologjia në vetmonitorimin dhe trajtimin e diabetit?  
Dr. Shk. Blertina Dyrmishi,  
Endokrinologe, Spitali Hygeia



17:15-17:30

Nefropatia diabetike tek pacientët me Transplant renal.  
Dr. Arjeta Dedej,  
Nefrologe, Spitali Amerikan



16:00-16:15

Qasjet ushqyese për parandalimin dhe menaxhimin e Diabetit të tipit 2.  
Dr. Shk. Albana Daka, Mjete laboratorit -  
Nutricioniste, Spitali Amerikan



17:30-17:45

Trajtimi i Diabetit Mellitus tip 2 tek pacientët obez me anë të Kirurgjisë bariatrike.  
Dr. Mirjeta Guni, Endokrinologe,  
Spitali Amerikan



16:15-16:35

Menaxhimi i dislipidemive tek pacientët me diabet.  
Dr. Indrit Temali, Kardiolog  
invaziv, Spitali Amerikan



17:45-18:00

Diskutime, Konkluzione

## Organizuar nga Shoqata AMEA – Albanian Medical Education Association

Kategoria e pjesëmarrësve: mjekë të të gjitha specialiteteve, endokrinologë, kirurgë, kardiologë, gjinekologë, peditër, nutricionistë, laborantë, mjekë të përgjithshëm, mjekë familjeje, mjekë urgjence, infermierë, mami, dentistë, farmacistë, fizioterapistë, studentë të mjekësisë apo shkencave të tjera mjekësore, etj.

### KOMITETI ORGANIZUES

Klodian Allajbeu  
Drejtor i Përgjithshëm  
Spitali Amerikan

Lindita Shosha  
Drejtoresh e Strategjisë Akademike  
dhe Edukimit Mjekësor

Mario Karaj  
Drejtor i Menaxhimit Spitalor  
Spitali Amerikan

Onejda Ymeraj  
Drejtoresh Operacionale  
Spitali Amerikan

### Sekretare Organizative

Albana Mehmeti  
Koordinatorë e Edukimit në Vazhdim

Email: secretary@amea.al  
Web: www.imca.al

Mob: 0684032151



Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Shk. Entela Puca** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Shk. Albana Daka** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Teuta Haveri** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Mirjeta Guni** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Indrit Temali** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Etleva Gjoshe** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Prof. Ass. Thanas Fureraj** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Shk. Bleritina Dyrmishi** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

Spitali Amerikan | American Hospital | Albanian Medical Education Association



**Dr. Arjeta Dedej** | Konferenca Mjekësore Endokrinologji

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 27 Qershor 2019 / 15:00-18:00

**PO 31 Qasjet mbi mënyrën e të ushqyerit për parandalimin dhe menaxhimin e diabetit të tipit 2***Daka A.*

**Hyrje:** Faktorët dietetik janë me rëndësi të madhe në menaxhimin dhe parandalimin e diabetit të tipit 2. Diabeti është një nga problemet më të mëdha të shëndetit publik në botë: Prevalenca vlerësohet të rritet nga 425 milionë njerëz në vitin 2017 në 629 milionë deri në vitin 2045, e lidhur kjo edhe me shpenzime shëndetësore, sociale dhe ekonomike. Nevojiten zgjidhje të ngutshme për të ngadalësuar, apo edhe për të kthyer këtë prirje, sidomos duke investuar në faktorë të modifikueshëm, që përfshijnë dietën, aktivitetin fizik dhe peshën. Ushqimi është një nga kontribuesit kryesorë të morbiditetit dhe vdekshmërisë në mbarë botën, sipas "Studimit të barrës globale të sëmundjeve" të kryera në 188 vende të botës.

Rëndësia e të ushqyerit në menaxhimin dhe parandalimin e diabetit të tipit 2 përmes efektit të saj në peshën trupore dhe kontrollin metabolik është e qartë. Megjithatë, ushqimi është gjithashtu një nga aspektet më të diskutueshme dhe të vështira të menaxhimit të diabetit të tipit 2.

Ideja e të qenurit në një "dietë" gjatë gjithë jetës, për një gjendje kronike, si diabeti është e mjaftueshme për të vënë shumë njerëz në vështirësi, duke ditur sa sfidues mund të jetë modeli i të ngrënit në këto raste. Terapia mjekësore e të ushqyerit ka futur një qasje sistematike dhe të bazuar në dëshmi për menaxhimin e diabetit përmes dietës dhe efektiviteti i saj është demonstruar, megjithatë vështirësitë mbeten. Megjithëse shumica e udhëzimeve të diabetit rekomandojnë fillimin e farmakoterapisë vetëm pas ndryshimit fillimisht të stilit të jetesës, duke përfshirë aktivitetin ushqimor dhe fizik, kjo nuk ndiqet gjithmonë në praktikë. Shumica e mjekëve nuk janë të trajnuar në ndërhyrje ushqimore dhe kjo është pengesë për këshillimin e pacientëve.

Është arritur progres në kuptimin e këshillave më të mira dietike për diabetin, por ende ekzistojnë probleme më të gjëra që duhen trajtuar në vazhdim.

**Qëllimi:** Ky studim synon të paraqesë një rishikim sistematik të literaturës së dëshmuar në dispozicion në lidhje me pyetjen klinike. Pyetja klinike e hetuar është: Cilat janë mënyrat më të mira ushqyese për parandalimin dhe menaxhimin e diabetit të tipit 2 në adultë?

**Konkluzione:** Të dhënat e udhëzuesve dietetik aktualë.

Në disa vende, kryesisht ato të zhvilluara, udhëzuesit ushqimorë për menaxhimin e diabetit kanë evoluar, nga fokusi tek dietat me yndyrna të ulta, tek njohja e faktit se më me rëndësi është cilësia e makronutrientëve (që do të thotë, lloji përkundrajt sasisë së makronutrientit), shmangia e ushqimeve të procesuara (veçanërisht sheqernat), dhe zakonet e përgjithshme ushqimore.

Një model i shëndetshëm ushqyerje, i cili vë theksin tek ushqimet me vlera ushqyese dhe sasi të duhura, aktiviteti fizik i rregullt, janë përparësi për të gjithë individët me diabet. Marrja e reduktuar e kalorive për personat prediabetikë ose me diabet tip 2, si dhe marrja e insulinës në përputhje me marrjen e duhur të karbohidrateve, duhet të merren parasysht.

**PO 32 Nefropatia diabetike tek pacientët me Transplant renal***Dedej A.*

**Hyrje:** Nefropatia diabetike prek 23 % në etiologjinë e ESRD-së tek marrësit e transplantit të veshkave. Incidenca e diabetit mellitus pas fillimit të transplantit (NODAT) është i ndryshueshëm, duke filluar nga 10 deri në 46% . **Metodologjia:** Simptomat e diabetit dhe glukozës së rastësishme të plazmës  $\geq 200$  mg / dL (11.1 mmol / L), glukozë esëll  $\geq 126$  mg / dL (7.0 mmol / L) dhe glukozë pas 2 orë ngrënie  $\geq 200$  mg / dL (11.1 mmol / L) gjatë testit të tolerancës së glukozës me gojë. Vlerat e Hb A1c janë shënues jo të besueshëm të NODAT gjatë 3-6 muajve të transplantimit të parë.

**Rezultate:** Në transplantin renal mjekimi më i zakonshëm përfshin glukokortikoidet, inhibitorët e calcineurin (CNIs), tacrolimus (TAC) dhe cyclosporinë (CYC) dhe inhibitorset (mTOR) rapamycin. Efekti diabetogjen i të gjitha këtyre barnave është hulumtuar në detaje dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e NODAT është sqaruar në disa studime të mëdha. Glukokortikoidet, si agjentët më të vjetër imunosupresivë, kanë një potencial më të fortë diabetogjenik, i cili është i varur drejtpërdrejt me dozën e tyre. Frenuesit e calcineurëve nxisin NODAT me anë të mekanizmave të ndryshme, duke përfshirë uljen e sekretimit të insulinës me një efekt toksik të drejtpërdrejtë në qelizat beta pankreatike.

Së fundmi, edhe pse me frekuencë më të vogël, inhibitorët mTOR vazhdojnë të përdoren midis pacientëve të transplantuar përkundër dëshmi klinike të përdorimit të tyre, duke u shoqëruar me rreziqe më të mëdha të dështimit të të gjitha transplantave dhe vdekjes së marrësit krahasuar me një regjim të bazuar në CNI. Nefropatia diabetike shfaqet në veshkën e transplantuar zakonisht pas rreth 5.9 vitesh.

**Konkluzione:** Në pacientët me DM pre-transplant dhe ata që zhvillojnë NODAT, gjetjet patologjike të transplantimit të DN pas veshkave janë në pjesën më të madhe të ngjashme me ato të DN tipike në veshkat e recipientit. Trashje e GBM dhe dëmtimi tubular janë tipike. DN në veshkën e transplantuar shpesh shoqërohet me ndryshimet vaskulare dhe tubulointersticiale shkaktuar nga flakja e allograftit, infeksionet virale, ose nephrotoksiciteti i CNI, e cila e dallon atë nga DN në veshkave të recipientit. Në pacientët, të cilët zhvillojnë DN me mikro dhe makroalbuminuri të dukshme përveç kontrollit të rreptë të glicemisë dhe përdorimit të frenuesve të angiotensinës dhe statinave mbeten golden standard në mjekim.

**PO033 Si ka ndikuar teknologjia në vetmonitorimin dhe trajtimin e diabetit?***Dyrmishi B.*

**Hyrje:** Numri i personave me diabet është rritur në të gjithë botën. Në 2017 numri i personave të diagnostikuar me diabet ishte 425 milion dhe ky numër pritet të rritet në vitet në vazhdim. Incidenca e diabetit në të gjithë botën është rritur, gjithashtu edhe ajo e diabetit tip1. Shkaku për rritjen e incidencës së diabetit tip1 nuk është i qartë, por mund të jetë një ndërthurje mes faktorëve gjenetikë dhe ambjentalë. Për shkak të komplikacioneve kronike, diabeti renditet ndër shkaqet kryesore të vdekjeve, prandaj, dhe mjekimi sa më i mirë i tij dhe parandalimi i komplikacioneve kërkon një kontroll sa më të mirë të glicemisë tek pacientët. Të dhënat epidemiologjike kanë treguar se të sëmurët me diabet mellitus tip1, që kanë një

kontroll optimal të glicemive zhvillojnë mbi dy episode të lehta, të hipoglicemisë në javë.

**Metodologjia:** Materiali shkencor u mor dhe u përpunua nga revistat e fundit në pubmed.

**Rezultatet:** Qëllimi kryesor i trajtimit të diabetit është mbajtja e glicemive të kontrolluara si edhe edukimi i pacientit për të bërë edhe vetë menaxhim të sëmundjes. Me zhvillimin e teknologjisë është më e mundur të arrihet kjo. Hypoglicemia ka qenë një nga barrierat kryesore në arritjen e targeteve të trajtimit të diabetit. Në ditët e sotme monitorimi i vazhdueshëm i glicemive dhe infuzioni i vazhdueshëm i insulinës ndërmjet pompave të insulinave ka bërë që pacientët të kenë një përshatje më të mirë të sasisë së insulinës së aplikuar sipas glicemisë. Me përdorimin e pompave të insulinës dhe me monitorimin e vazhdueshëm të glukozës është e mundur të ulen episodet e hipoglicemive dhe të ketë injeksione shtesë të insulinës, në rastin e vlerave të larta të glicemisë, duke arritur në ekuilibrim më të mirë të diabetit e për rrjedhojë në zvogëlimin dhe mënjanimin e komplikacioneve kronike të diabetit.

**Konkluzione:** Përdorimi i teknologjisë në ditët e sotme, lejon të kryhet një vetë monitorim më i mirë i glicemive, duke bërë më të lehtë të arrihen targetet e trajtimit të diabetit, dhe duke mundësuar zvogëlimin dhe trajtimin në kohë të episodeve të hypoglicemisë.

## PO 34 Strategjitë e reja terapeutike për menaxhimin e Diabetit Mellitus tip2

*Puca E.*

**Hyrje:** Diabeti është një sëmundje serioze, kronike progresive që karakterizohet nga hiperglicemia e shkaktuar kjo ose nga deficit i sekretimit të insulinës, ose kur organizmi nuk e përdor në mënyrë efikase. Shumë medikamente të reja janë aprovuar për trajtimin e diabetit, këto vitet e fundit. Është e rëndësishme të kuptojmë efikasitetin dhe sigurinë e tyre në mënyrë që të përdoren sa më saktë në trajtimin e diabetit.

**Qëllimi:** Përditësimi i udhërrëfyeseve më të fundit, në lidhje me efikasitetin dhe sigurinë e medikamenteve antidiabetike në trajtimin e diabetit.

**Metodologjia:** Reviu e literaturës në lidhje me strategjitë e reja terapeutike në menaxhimin e diabetit. Ne kërkuam në PubMed me fjalët kyçe: diabet mellitus dhe anti diabetiket oral.

**Rezultatet:** Nga kërkimi rezultuan që për një periudhë 10 vjeçare janë publikuar 184 artikuj. Vetëm në 5 vitet e fundit ishin 91 artikuj. Në të gjithë udhërrëfyesit është vënë theksi tek rëndësia e mbajtjes nën kontroll të diabetit, me qëllim që të ulim riskun e shfaqjes së komplikacioneve. Për arritjen e këtij qëllimi, është e dosmosdoshme ndryshimi i stilit të jetesës (ku përfshihet rregjim ushqimor i shëndetshëm dhe aktiviteti fizik) dhe përdorimi i medikamenteve. Aktualisht, dekadën e fundit janë në përdorim një sërë klasash të reja antidiabetikësh, të cilët veprojnë në mekanizma të ndryshëm fizio-patologjik dhe i japin mundësi klinicistëve të jenë, sa me efikas në menaxhimin e diabetit. Metformina mbetet zgjedhja e parë, përveç rasteve, kur ajo është e kundër indikuar. Shkaku kryesor i morbiditetit dhe mortalitetit në pacientët me diabet është sëmundja kardiovaskulare. Në rast se me monoterapi, nuk arrihet targeti i dëshiruar i Hemoglobinës së glukozuar ( $HbA1c < 7\%$ ), zgjedhja e medikamentit të dytë bëhet duke marrë në konsideratë dhe prezencën/ose jo të sëmundjeve bashkëshoqëruese. Dy klasat e reja: 1. Agonistët e receptorëve të glucagon-like peptide-1 (GLP-1 RA) dhe 2. Frenuesit selektivë të sodium glucose transporter 2 (SGLT2), kanë demonstruar përfitime kardiovaskulare përtej pritshmërive të parashikuara. Këto dy klasa kanë sfiduar algoritmat që ishin në përdorim në praktikën klinike. Në përzgjedhjen e medikamenteve, pas metforminës, duhet gjithashtu, të meren parasysh dhe një sërë faktorësh të tjerë: Cili është niveli që dëshirohet për HbA1c, risku për hypoglicemi, efekti në peshën trupore, efikasiteti i medikamentit, efektet anësore, kostoja, mënyra e përdorimit (tabletë vs injeksion), nëse janë të pranishëm në tregun farmaceutik të vendit tonë, etj. Trajtimi i diabetit tip1 është vetëm me insulinë. **Konkluzione:** Diabeti është një sëmundje kronike e cila kërkon një skuadër multidisiplinore, ku të përfshihen profesionistët e ndryshëm të shëndetit, dietologët, pacienti dhe familja e tij. Trajtimi i diabetit tip2 është tashmë një proces shumë kompleks, duke marrë parasysh numrin e madh të medikamenteve antihyperglycemicantë që janë tashmë në përdorim. Duke e vendosur pacientin në qendër dhe duke i ofruar këshilla dhe mbështetje të vazhdueshme, përzgjedhja e medikamenteve duhet të bëhet duke patur parasysh: Sigurinë, sëmundjet bashkëshoqëruese, tolerancën ndaj medikamentit, efektivitetin, çmimin dhe thjeshtësinë në përdorim.

## PO035 Diabeti i shtatzënisë – kritere të ekzaminimit dhe diagnostikimit

*Gjoshe E.*

**Hyrje:** Shtatzënia është një gjendje komplekse metabolike që përfshin ndryshime dramatike dhe në mjedisin hormonal, përveç ndryshimeve në adipocite dhe citokinë inflamatore. Placenta është përgjegjëse për prodhimin e hormoneve, të cilat riprogramojnë fiziologjinë e nënës për t'u bërë rezistente ndaj insulinës në tremujorin e dytë dhe të tretë të shtatzënisë për të siguruar në këtë mënyrë një furnizim të mjaftueshëm me ushqyes për fetusin në rritje. Diabeti i shtatzënisë (gestational-GDM), nënkupton diabetin e diagnostikuar për herë të parë gjatë gjysmës së dytë të shtatzënisë, ndërkohë që një diabet i diagnostikuar në tremujorin e parë të shtatzënisë karakterizohet nga ndjeshmëri e shtuar ndaj insulinës dhe është sygjerues për një diabet preekzistent. **Metoda:** Identifikimi i grave shtatzëna me diabet, fillimi i terapisë së përshtatshme dhe monitorimi nga afër, mund të ulin rrezikun e ndërlikimeve të mundshme të shtatzënisë (të fetusit dhe të nënës), veçanërisht makrosominë, polihidramnios, distocin e shpatullës dhe preeklampsinë (2,3). Në dallim nga gratë me diabet pregestational, gratë me GDM të vërtetë nuk janë në rrezik për të lindur foshnja me keqformime kongenitale, sepse fillimi i çrregullimit të metabolizmit glicemik ndodh pas organogenezës. Për pacientët me rrezik për DM vlerësimi i glicemisë duhet kryer që në konsultën e parë obstretikale (glicemi esëll, HbA1c), ndërsa te gjitha shtatzënat të pa ekzaminuara, apo me rezultat normal në vlerësimin e parë, u nënshtohen ekzaminimit në javën 24-28 të shtatzënisë. Nuk ka një konsensus unanim për depistimin e GDM, ndaj mund të përdoret ekzaminimi në një hap me TTOG me 75gr glukozë; ose me dy hapa, fillimisht me 50 mg, dhe për vlera mbi normë vazhdohet me TTOG me 100gr glukozë. (4-9). Shumë gra arrijnë vlera të mira të glicemisë vetëm nën trajtim nutritional (dhe aktivitet fizik), por deri në 30% e tyre kanë nevojë për trajtim medikamentoz.

Trajtim medikamentoz bazë dhe unanimisht i aprovuar në trajtimin e GDM është insulinoterapia.

**Rezultati:** Pas lindjes, niveli i glicemive normalizohet, por pacientët mbeten në rrezik për GDM në shtatzënitë e ardhshme, për tolerancë të dëmtuar ndaj glukozës apo dhe DM në vitet në vijim.

Të gjitha gratë me GDM duhet të inkurajohen që të ushqejnë me gji dhe duhet të rivlerësohen me një test tolerancë me 75 gram glukozë, në intervalin 6 - 12 javë pas lindjes.

### PO 36 Menaxhimi i dislipidemive tek pacientët me diabet

Temali I.

**Hyrje:** Sëmundja kardiovaskulare është shkaku më i shpeshtë i sëmundshmërisë dhe i vdekshmërisë tek pacientët me diabet dhe megjithëse është reduktuar shumë rreziku, këta individë kanë dy herë më shumë rrezik se të tjerët për të pasur evente aterosklerotike. Menaxhimi agresiv i dislipidemisë është shumë i rëndësishëm për të ulur këtë rrezik. Diabeti dhe insulinorezistenca shoqëruese nxisin ndryshime në cilësinë dhe sasinë e profilit lipidik, që ndikon dhe në trajtimin efektiv të tij.

**Qëllimi:** Në këtë prezantim do të paraqiten rekomandimet për menaxhimin sa më të saktë të dislipidemisë diabetike.

**Metodologjia:** Reviu e literaturës dhe e guideline-ve, në lidhje me menaxhimin sa më efikas të dislipidemisë diabetike.

**Rezultatet:** Dislipidemia diabetike karakterizohet nga rritje e nivelit të triglicerideve, ulje e nivelit të lipoproteinave me densitet të lartë (HDL – C) dhe predominancë e LDL kolesterolit. Studimet e fundit klinike kanë siguruar të dhëna, që terapia për uljen e nivelit të lipideve ka të njëjtin efekt në rezultatet kardiovaskulare, si tek të sëmurët diabetikë edhe tek ata jodiabetikë. Sipas lineave-guidë aktuale, targeti i nivelit të LDL kolesterolit është < 100 mg/dL (< 70 mg/dL në pacientët me risk shumë të lartë) dhe statinat janë trajtimi i zgjedhur. Në arritjen e targetit lipidik vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet modifikimit të stilit të jetesës, si dietës, ushtrimeve fizike, ndalimit të pirjes së duhanit, humbjes në peshë dhe kontrollit të glicemisë. Statinat janë trajtimi i zgjedhur në dislipidiminë diabetike, por shpesh mund të nevojitet një kombinim i medikamenteve që ulin nivelin e lipideve. Kombinimet e këtyre agjentëve antilipidik janë të shumtë dhe ka shumë faktorë që duhet të merren në konsideratë në përcaktimin e strategjisë sa më të përshtatshme.

**Konkluzion:** Identifikimi dhe trajtimi efikas i dislipidemisë është element shumë i rëndësishëm në parandalimin e sëmundjes koronare të zemrës tek të sëmurët diabetikë. Megjithëse statinat janë medikamenti i zgjedhur në dislipidiminë diabetike, tek pacientët me risk të lartë duhet të merret në konsideratë dhe kombinimi i antilipidikëve.

### PO 37 Trajtimi i Diabetit Mellitus tip2 tek pacientët obez me anë të kirurgjisë bariatrike.

Guni M.

**Hyrje:** Një nga faktorët madhor të rrezikut së shfaqjes dhe persistimit të DM tip2 është obeziteti, ndaj dhe rënia në peshë mbetet një nga shtyllat kryesore të trajtimit të DM tip 2. Një mënyrë efektive për të arritur rënien në peshë dhe remisionin e Diabetit është kirurgjia bariatrike. Normalizimi i glicemive pas kirurgjisë arrihet në 80% të pacientëve dhe është rezultat i kombinimit të një sërë faktorëve; kufizimit të marrjes së kalorive, uljes së rezistencës insulinike dhe rritjes së sekretimit të insulinës. Kirurgjia bariatrike rekomandohet në pacientet me DM tip2 të cilët kanë BMI (body mass index) mbi 35 kg/m<sup>2</sup>.

Eksperienca jonë në trajtimin me kirurgji bariatrike të DM tip2 në pacientët me BMI mbi 35 kg/m<sup>2</sup> ka rezultuar efektive në të gjitha rastet. **Metoda:** Ky studim retrospektiv i kryer në 10 pacientë me DM tip 2 apo dëmtim të tolerancës së glukozës dhe obezitet, të cilët iu nënshtruan kirurgjisë bariatrike (sleeve gastrectomy ose Roux-en Y bypass) gjatë një periudhe 12 mujore (2017-2018), synon vlerësimin e përmirësimit të glicemive pas interventit dhe monitorimin e tyre për një periudhë 1 vjeçare. BMI e pacientëve që iu nënshtruan interventit kirurgjikal, lëvizte nga 35-64 kg/m<sup>2</sup>, mosha mesatare 38 vjeç (varionte nga 30-55), 4 prej tyre ishin meshkuj dhe 6 femra. Me DM tip 2 nën trajtim me antidiabetik oral apo insulinoterapi, apo tolerancë të dëmtuar të glicemive, me vlera të ekuilibruara ose jo të glicemive nën trajtim, ku me dietë dhe aktiviteti fizik nuk arrihej ruajtja e peshës trupore normale. Pacientët që iu nënshtruan RYGB ishin me BMI më të lartë se ato që iu nënshtruan Gastric sleeve (mesatarja 43 kg/m<sup>2</sup> për pacientët që iu nënshtruan RYGB dhe 38 kg/m<sup>2</sup>, për ato që iu nënshtruan Gastric sleeve). Vlerësimi i pacientëve u bë para interventit si dhe në javën e parë, pas 3 muajsh, 6 muajsh dhe 12 muajsh, nga interventi dhe konsistoi në: ekzaminimin fizik, Body Mass Index (BMI), vlerësimin nutricional dhe psikologjik, si dhe ekzaminimet laboratorike si hemogramë, glicemi esëll dhe 2 orë pas buke, HbA1c, azotemia, kreatinemi, elektrolitet dhe lipidogramë.

**Rezultatet:** Të dy metodat (Gastric sleeve dhe RYGB) rezultuan efektive, në trajtimin e obezitetit dhe përmirësimin e sindromit metabolik. Përmirësimi i glicemive, u vu re në të gjithë pacientët, qysh në ditët e para pas interventit dhe në të gjithë pacientet HbA1c persistonte nën 6.5% vitin e parë pas interventit, pa trajtim me antidiabetike orale apo insulinë. Rënia në peshë efektive (humbje e mbi 50% të mbipeshes) u arrit brenda 6 muajve pas interventit.

**Konkluzion:** Kirurgjia bariatrike mbetet një metodë efektive për trajtimin e obezitetit dhe sindromit metabolik, në pacientët me BMI mbi 35 kg/m<sup>2</sup> dhe me komplikacione kronike të obezitetit kur metodat e tjera konvencionale, të trajtimit kanë dështuar. Përmirësimi i glicemive dhe parametrave të tjerë të sindromit metabolik u arrit në të gjithë pacientet që iu nënshtruan kirurgjisë bariatrike.

### PO 38 Risitë në trajtimin e Retinopatisë diabetike

Haveri T.

**Përshkrim:** Retinopatia diabetike mbetet një nga shkaqet kryesore të verbimit edhe në ditët e sotme, në moshat aktive për punë. Sipas WHO, sot numërohen rreth 387 milionë njerëz me diabet mellitus, prej të cilëve 93 milionë me retinopati diabetike, 17 milionë që paraqesin retinopati diabetike proliferative dhe 28 milionë me komplikacion të rëndë, atë RD që rrezikonë verbërinë. Mekanizmi fiziologjik – patologjik: Në bazë të mekanizmit fiz-pat të retinopatisë diabetike, qëndron hiper-glicemia persistente, e cila sjell për pasojë dëmtimin e enëve të vogla, të gjakut (mikroangiopatia diabetike). Më pas vijon një kaskadë me pasojë: Humbja e periciteve të kapilarëve, shkatërrim i barrierës interne gjak-retinë, ekstravazimi i serumit

dhe elementëve të gjakut dhe grumbullimin e tyre në retinë, me pasojë formimin e edemës makulare cistoide dhe eksudate të forta, të cilët shkaktojnë ulje të pamjes. Ky është stadi i retinopatisë diabetike jo proliferative, i cili nëse nuk trajtohet, sjell për pasojë ishemi kronike të zonave të veçanta të retines, rritje të sekrecionit të substancave VEGF, të cilët nxisin angiogenezën dhe neovaskularizimin. Këto dy të fundit mund të çojnë në hemorragji intravitreale, traksion të retinës dhe glaukomë neovaskulare, forma të retinopatisë diabetike proliferative me pasojë verbimin.

**Qëllimi i trajtimit:** Trajtimi i retinopatisë diabetike pre proliferative konsiston në frenimin e mekanizmave që mund të bëhen shkak për evolucionin në retinopati proliferative. Këto mekanizma janë ekzistenca e zonave të ishemisë retinale dhe prodhimi i substancave VEGF. Trajtimi bazohet në frenimin dhe neutralizimin e tyre. Ndërsa në stadin e retinopatisë diabetike proliferative trajtimi është kirurgjikal nëpërmjet vitrektomisë posterior, absorbimit të hemorragjisë intravitreale dhe prerjes së traksioneve vitreo-retinale.

**Metodat:** Evidentimi i edemes makulare cistoide është një moment kyç në trajtimin e retinopatisë diabetike, sepse sinjalizon se ka filluar prodhimi i substancave VEGF. Përcaktimi dhe majtja e sasisë së edemës makulare realizohet nëpërmjet aparaturës Optical Coherence Tomography. OCT është një risi e kohëve të fundit, e cila ka mundësuar zbulimin dhe stadifikimin më të shpejtë e më të thjeshtë të RD. Trajtimi inovativ bazohet në injektimin intravitreal të substancave anti VEGF si: Aflibercept /Ranibizumab/Bevacizumab (2 të parat të miratuara për përdorim intravitreal në 2012 dhe 2014 nga FDA). Gjithashtu, nuk e kanë humbur ende vlerën trajtimet më të hershme me antinflamatorë steroide si kortizonikvt: Ozurdex (Dexamethasone) 0.7 mg/ Flucinolone Acetonide) 0.19 mg, të cilët aplikohen në formë implanti apo injeksione intravitreale. Evidentimi i zonave të ishemisë retinale bazohet në ekzaminimin e angiografisë me fluoresceine, ndërsa trajtimi i tyre në aplikimin e terapisë me argon laser. Ky i fundit aplikohet në formën e laser fokal, panretinal fotocoagulation ose grid laser, në trajtimin e makulopatisë diabetike. Kirurgjia vitro-retinale është shpëtimi i vetëm për retinopatitë diabetike proliferative dhe hemorragji intravitreale persistente. Avancimi i kësaj kirurgjie, futja e kirurgjisë mikroinvazive 25 dhe 27 G, na mundësojnë së fundmi, ndërhyrje më të shpejtë dhe rezultate më të mira me rastin e RD proliferative.

**Konkluzion:** Evolucionin e teknologjisë ka mundësuar futjen në përdorimin klinik të aparaturave të avancuara, si OCT, e cila mundëson ekzaminimin më të hershëm dhe minimalisht invaziv të pacientit diabetik. Vizualizimi dhe ndjekja e edemës makulare diabetike është bërë më i thjeshtë dhe me pak invaziv për pacientin. Aplikimi i substancave anti VEGF, përfaqëson një alternativë dhe shpesh herë janë komplementare ndaj trajtimit klasik me laser fotokoagulim. Aplikimi i kirurgjisë vitreo retinale 25 dhe 27 G, mundëson trajtim më të hershëm dhe rikuperim më të shpejtë, në rastin e retinopatisë diabetike proliferative. Me vlerë të pazëvendësueshme është sigurisht depistimi dhe zbulimi i hershëm i retinopatisë diabetike (kontrollet rutinë të fundus oculi - çdo 6 muaj te okulisti) si dhe ruajtja e vlerave të qëndrueshme të glicemisë në bashkëpunim me mjekun endokrinolog (glicemia, HbA1C) për të ruajtur rezultate të qëndrueshme afatgjata.

## PO 39 Të dhëna epidemiologjike, llojet dhe diagnostikimi i diabetit

*Fureraj Th.*

**Hyrje:** Diabetes Mellitus ose thjesht Diabeti, është një nga sëmundjet e njohura më herët tek qeniet humane. Përshkrimet e para në papiruset egjiptiane datojnë 1500 vjet para Krishtit. Por termi "Diabetes" u përshkrua së pari Arataeus of Cappadocia dhe termi "Mellitus" u shtua me vonë nga Thomas Willis me 1675.

**Qëllimi:** Reviu e literaturës në lidhje me epidemiologjinë, llojet e diabetit dhe diagnostikimi tij.

Rritja pandemike e diabetit përben aktualisht një problem të madh të shëndetit publik. Në vitin 1980 diabetikët përbënin 4.7% të popullatës së përgjithshme, ose 108 milionë. Në vitin 2014 përbënin 8.4% ose 422 miliona diabetike. Parashikimet për vitin 2035 janë më të zymta ku numri i diabetikeve parashikohet të jetë 592 milionë. Moshat më të prekura janë ato midis 40-59 vjet. Kompleksiteti dhe heterogeniteti i këtij çrregullimi metabolik qëndron në bazë të klasifikimit të diabetit. Deficit insulinik ndryshon në varësi të tipit të diabetit:

Diabeti Tip I – si pasojë e destruksionit të qelizave beta çon në deficit absolut të insulinës.

Diabeti Tip II – mund të kemi rezistencë të rritur periferike ndaj insulinës me deficit relative në insulinë, por mund të kemi dominim edhe të insulinosekrecionit me rezistencë insulinike.

Diabeti gestacional (i barrës) është një tip diabeti që zhvillohet vetëm gjatë barrës, zakonisht në javën e 24 deri në javën e 28-të dhe pas lindjes normalizohet.

Tipa të tjerë specifk të diabetit ku mund të përmendim diabetin nga defekte gjenetike, të funksionit të qelizës beta, por dhe defekte që kushtëzojnë veprimin e insulinës, patologjitë e pankreasit ekzokrin, endokrinopatitë, medikamentoz, infeksioz, etj.

Diabeti shoqërohet me ndërlikime akute dhe kronike, duke rritur kështu invaliditetin dhe mortalitetin. Në vitin 2016, diabeti renditej i shtati në shkaqet e mortalitetit. Për të parandaluar këto komplikacione duhet diagnostikim i hershëm i mbështetur në kritere të qarta.


Diagnoza e diabetit mbështetet në matjen e glicemisë esëll, e cila duhet të jetë  $\geq 126$  mg/dl (7.0 mmol/l) në kushtet që pacienti të jetë 8 orë esëll.

Glicemia 2 orë pas glukozes (75 g glukozes) duhet të jetë  $\geq 200$  mg/dl (11.0 mmol/l).

Kriter tjetër diagnostik është HbA1c, e cila duhet të jetë  $\geq 6.5\%$  (ose 48mmol/mol). Dhe së fundi, janë diabetikë pacientët me shenja klinike dhe me glicemi të rastit  $\geq 200$ mg/dl.

**Konkluzion:** Të dhënat epidemiologjike parashikojnë një rritje globale në shifra, gati pandemie të diabetit, ndaj si rrjedhojë parandalimi, diagnostikimi sa më herët i diabetit dhe ndërlikimeve akute apo kronike, duhet të jetë një prioritet për të gjithë.

# Konferenca Mjekësore Hematologji-Histopatologji



## Fokus "Trajtimi i Mielomës Multiple dhe Transplanti i qelizave burimore hematopietike - Një realitet i ri trajtimi në Shqipëri"

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë  
25 Korrik 2019 | 15:00 - 18:00

### PROGRAMI SHKENCOR:

Moderator: **Dr. Sotiraq Lako**

**15:00-15:25**

**Evolucioni darvinian i kancerit.**  
Dr. Sotiraq Lako, Hematolog,  
Spitali Amerikan



**15:25-15:55**

**Imunohistopatologjia e palcës  
së kuqe të kockave tek  
Mieloma multiple.**  
Dr. Shk. Leart Bërdica, Shef i  
Departamentit të Anatomisë  
Patologjike, Spitali Amerikan  
dhe mjek në Shërbimin e  
Anatomisë Patologjike QSUT



**15:55-16:25**

**Mieloma multiple – Etiologjia,  
fispatologjia, klinika, diagnoza,  
principet e trajtimit.**  
Dr. Blerina Koprencka,  
Hematologe, Spitali Hygeia



**16:25-16:50**

**Testet diagnostike laboratorike  
për Mielomën multiple.**  
Dr. Irena Marku, Mjete Laboratori,  
Spitali Amerikan



**16:50-17:15**

**Gamopatia monoklonale me  
rëndësi klinike (MGCS) - kur MGUS  
nuk është më i parëndësishëm.**  
Dr. Arjeta Dedej, Nefrologe,  
Spitali Amerikan



**17:15-17:45**

**Misioni MRD - Kontroll kundrejt  
shërim dhe Transplanti i Qelizave  
burimore hematopietike  
- Realitet i ri trajtimi në Shqipëri.**  
Dr. Sotiraq Lako, Hematolog,  
Spitali Amerikan

**17:45-18:00**

**Diskutime, Konkluzione**

### Organizuar nga Shoqata AMEA – Albanian Medical Education Association

Kategoria e pjesëmarrësve: Klinikistë, hematologë, patologë, kardiologë, radiologë, kirurgë, anesteziistë, mjekë familjeje, pediatër, nefrologë, mjekë të përgjithshëm, mjekë urgjence, infermierë, mami, dentistë, farmacistë, laborantë, studentë të mjekësisë apo shkencave të tjera mjekësore, etj.

#### KOMITETI ORGANIZUES

Klodian Allajbeu  
Drejtor i Përgjithshëm  
Spitali Amerikan

Lindita Shosha  
Drejtoreshë e Strategjisë Akademike  
dhe Edukimit Mjekësor

Mario Karaj  
Drejtor i Menaxhimit Spitalor  
Spitali Amerikan

Onejda Ymeraj  
Drejtoreshë Operacionale  
Spitali Amerikan

#### Sekretaria Organizative

Albana Mehmeti  
Koordinatorë e Edukimit në Vazhdim

Email: secretary@amea.al  
Web: www.imca.al

Mob: 0684032151




Spitali Amerikan | Instituti Kombëtar i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore | Albanian Medical Education Association

**Dr. Shk. Sotiraq Lako**

**Konferenca Mjekësore  
Hematologji-Histopatologji**

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 25 Korrik 2019 / 15:00-18:00



Spitali Amerikan | Instituti Kombëtar i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore | Albanian Medical Education Association

**Dr. Arjeta Dedej**

**Konferenca Mjekësore  
Hematologji-Histopatologji**

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 25 Korrik 2019 / 15:00-18:00



Spitali Amerikan | Instituti Kombëtar i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore | Albanian Medical Education Association

**Dr. Shk. Leart Bërdica**

**Konferenca Mjekësore  
Hematologji-Histopatologji**

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 25 Korrik 2019 / 15:00-18:00




Spitali Amerikan | Instituti Kombëtar i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore | Albanian Medical Education Association

**Dr. Irena Marku**

**Konferenca Mjekësore  
Hematologji-Histopatologji**

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 25 Korrik 2019 / 15:00-18:00



Spitali Amerikan | Instituti Kombëtar i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore | Albanian Medical Education Association

**Dr. Blerina Kopencka**

**Konferenca Mjekësore  
Hematologji-Histopatologji**

Salla e Konferencave, Spitali Amerikan 3, Tiranë | 25 Korrik 2019 / 15:00-18:00

**PO 40 Gamopatia Monoklonale me Rëndësi Klinike (MGCS). Kur MGUS nuk është më i parëndësishëm - Paraqitje rasti/Case report.***Dedej A.*

**Hyrje:** Gamopatia Monoklonale me Rëndësi të Papërcaktuar (MGUS), është prezent në rreth 3 % të popullatës mbi 50 vjeç dhe progreson në MM ose në sëmundje malinje të lidhura më të, me një frekuencë prej 1 % në vit. MGUS pavarësisht shkallës të ulët të malinjitetit, në disa raste ka potencial për simptomatikë të rëndësishme.

Në këto raste flitet për Gamopatia Monoklonale me Rëndësi Klinike (MGRS), ku dëmtimi renal nga paraproteina e klonit malinj të MGUS është më e shpeshta. Glomerulopatia C3 është një formë e rallë e glomerulonefritit, pasojë e defekteve në rrugën alterne të kaskadës së komplementit. Karakterizohet nga depozitime glomerulare të faktorit C3 të komplementit.

**Metoda:** Ne do të paraqesim rastin e një pacienti me MGRS, 61 vjeç, me hematuria, anemia, disfunkcion renal, proteinuria. Pacienti ishte transplantuar (veshka) dy vite më parë dhe ishte nën trajtim me krotizonikë, Tacrolimus dhe Entecavir për HBV. Në analizat hematobiokimike, konstatohet një pik i vogël në zonën e gamaglobulinave. Realizohet mielograma/biopsia e PKK dhe konfirmohet diagnoza e MGUS. FISH t (11; 14) (q13; q32) Biopsi renale konfirmon glomerulopatia C3 me proliferacion mesengjik dhe të përhapur endokapilar.

Gammopatia monoklonale me rëndësi renale MGRS është një term për të përshkruar një grup të çrregullimeve hematologjike të shoqëruara me sëmundjen e veshkave që nuk arrijnë të përmbushin përkuizimet standarde për MM ose limfomën.

**Konkluzion:** Në raste të tilla, dëmtimi i veshkave është i lidhur më sëmundjen bazë hematologjike. Qëllimi është të bëjmë dallimin midis MGUS, nja patologji beninje, asimptomatike me MGRS, që shoërohet me sëmundshmëri dhe vdekshëmri.

**PO 41 Mieloma Multiple – Etiologjia, fispatologjia, klinika, diagnoza, principet e trajtimit***Koprencka B.*

**Hyrje:** Mieloma është sëmundje tumorale malinje, proliferim dhe infiltrim neoplazik, monoklonal (në fakt shumë nënklone, me origjinë nga një qelizë e vetme) i qelizave plazmatike të mirë diferencuara (malignant B-cell neoplasm), në një vatër të vetme (solitare) apo shumë vatra (multiple) në Palcën e Kuqe të Kockave (PKK), me pasojë insuficiencën e PKK dhe dëmtimin kockor; si dhe prekje të mundshme ekstramedulare (pasojë e proliferimit dhe infiltrimit qelizor malinj/depozitimit të proteinës monoklonale).

MM aktive është pasojë klinike e një procesi shumëshkallësh transformimi evolucionar darvinian, që fillon nga

- a) predispozicioni gjenetik
- b) ngjarjet e fillimit të mielomës
- c) një gjendje beninje (premalinje), asimptomatike, Gamopatia Monoklonale me Rëndësi të Papërcaktuar (MGUS), për t'u transformuar në
- d) Smoldering (asimptomatik) MM, në e) MM simptomatike (aktive)
- f) High-risk MM ku përfshihen dhe Leukoza Plazmocitare dhe Mieloma Ekstramedulare.

Sipas kriterëve të rishikuara të IMWG në 2014, vendosja e diagnozës së MM kërkon plotësimin e të dy kriterëve:

- a) praninë e 10 % ose më shumë ( $\geq 10\%$ ) qeliza plazmatike klonale (malinje, jo totale) në PKK (të vërtetuar me imunfluoreshencë, NGS, NGF, MFC nga aspirimi random i PKK), pra minimumin e infiltrimit të



PKK me qeliza plazmatike malinje ose mieloma medulare e provuar me random biopsi (imunohistokimia), ose një plazmocitomë kockore/ekstramedulare të provuar me biopsi (imunohistokimi), plus, b) praninë e një ose më shumë, të paktën e njërës ( $\geq 1$ ) prej CRAB Criteria.

**Metoda:** Trajtimi i sëmundjes përcaktohet nga mosha e pacientit, sëmundjet bashkëshoqëruese dhe faktorët citogjenetike. Terapia me dozë të lartë e bashkëshoqëruar me transplantimin e qelizave buri-more hematopoitike autologe (Auto-HSCT) mbetet trajtimi i zgjedhur për pacientët nën moshën 70 vjeç, të cilët janë në gjendje të mirë shëndetësore.

**Rezultate:** Si rrjedhim i përdorimit të preparateve të reja, auto-HSCT, mbijetesa mesatare e pacientëve me MM është zgjatur dukshëm, me synimin e afërt, përcaktimin e MM si një sëmundje potencialisht të shërueshme.

## PO 42 Testet Diagnostike Laboratorike për Mielomën Multiple

*Marku I.*

Testet laboratorike specifike tek pacientët që dyshohen për MM, sipas rekomandimeve të IMW janë:

1. Elektroforeza dhe Imunoelektroforeza e Proteinave në serum dhe urinë.
2. Vargjet e lehta të lira në serum.
3. Beta-2 mikroglobulina në serum, albumina dhe matja e LDH.
4. FISH.
5. Ekzaminimi i skeletit dhe indeve të buta me CT/MRI.
6. Asprimi i PKK/Biopsia e PKK/Imunofenotipi dhe Histokimia.

Krahas testeve standarte hematobiokimike, për vlerësimin e anemisë, prekjes së funksionit renal, kalçemisë, si serumi ashtu edhe urina, duhet të vlerësohen për proteinën monoklonale.

Matja sasiore e proteinës totale, përcaktimi i gama globulinave, pikut monoklonal, sasia e M proteinës me Elektroforezën e proteinave, përcaktimi i monoklonalitet me Imunofksimin, përcaktimi i sasisë së imunoglobulinave me anë të Imunoelektroforezës së Proteinave, përcaktimi i vargjeve të lehta të lira janë analiza thelbësore për vendosjen e diagnozës së MM.

Për çdo pacient do të realizohet ekzaminimi citogjenetik për të bërë shtresëzimin e tyre sipas rrezikut citogjenetik dhe në varësi të këti rreziku do të përcaktohet dhe strategjia e trajtimit të tyre.

## PO 43 Imunohistopatologjia e Palcës së Kuqe të Kockave tek Mieloma Multiple

*Bërdica L.*

**Hyrja:** Neoplazite plazmocitare janë çrregullime variabel të proliferimeve monoklonale të qelizave që prodhojnë imunoglobulina që mund të jenë limfocite ose qeliza plazmocitare.

**Metoda:** Rishikim-Review literature dhe i klasifimit të WHO(2008)

**Rezultatet:** Mieloma multiple (MM) karakterizohet nga proliferimi neoplazik, i qelizave plazmatike monoklonale.

Diagnoza e MM mbështetet në kriteret e propozuara nga IMWG dhe të dhënat patologjike. Aspirimi dhe Biopsia e Palcës së Kuqe të kockave janë domosdoshmëri për vendosjen e diagnozës. Shkalla e infiltrimit të PKK nga qelizat patologjike mielomatoze është e rëndësishme për diagnozën dhe prognozën e Mielomës Multiple.

Zakonisht, ekzaminimi i PKK (palcës së kuqe të kockës) realizohet në zonat ku PKK arrihet më lehtë, në pelvis dhe sternum, por biopsia e lezionit është e rëndësishme për vendosjen e diagnozës.

PKK duhet të ekzaminohet për ndryshimet e mundshme citogjenetike (FISH) dhe imunofenotipike. Gjithashtu, ngjyrimet imunohistokimike sigurojnë identifikimin e qelizave plazmatike, duke u mbështetur tek specificiteti i lartë i CD138 tek këto qeliza. Shprehja anormale e CD56 tek qelizat plazmatike, tregon për natyrën malinje të këtyre qelizave, duke vendosur përfundimisht diagnozën e Mielomës Multiple.

Përveç rasteve të MM kemi edhe variante të tjera në kufi apo të përbëra klinike me karakteristikat imunohistopatologjike dhe klinike si:

Plasma cell myeloma

Plasmacytoma

Monoclonal immunoglobulin deposition diseases

Monoclonal gammopathy of undetermined significance (MGUS)

Osteosclerotic myeloma (POEMS syndrome)

Diskutimi: Është shumë e rëndësishme në ditët e sotme që vlerësimi i neoplazive plazmocitare të mirëdefinuara të bëhet edhe në sfondin subklinik ose koincidental me çrregullime të tjera hematologjike komplekse.

#### **PO 44 Kontroll kundrejt Shërim. Misioni MRD. Transplanti i Qelizave Burimore Hematopietike, realitet i ri trajtimi në Shqipëri"**

*Lako S.*

**Hyrje:** A është shërimi i MM një endërr apo mund të bëhet realitet?

MM është konsideruar prej dekadash si sëmundje e moshave të vjetra, me shumë pak opsione terapeutike (alkilantët dhe kortizonikët).

Qëllimi ishte vetëm kontrolli i sëmundjes, me përgjigje të përgjithshme ndaj mjekimit (ORR) prej 50 %, me Remision Komplet Konvencional të rastësishëm dhe mbijetesë të përgjithshme prej 2-3 vitesh.

Në fakt, shërimi konsiderohej i paarrtshëm. Përfshirja e terapisë me dozë të lartë (HDT/ASCT) dhe veçanërisht e preparateve të reja, nxitën një debat të ri rreth mundësisë së shërimit të një pjese të rëndësishme të pacientëve me MM.

**Metoda:** Përdorimi i terapive të reja, përmirësimi i trajtimit të suportit është shoqëruar me rritje të jetëgjatësisë së përgjithshme në dekadën e fundit 2-3 herë.

Transplanti i Qelizave Burimore/Progenitore Hematopietike (HSCT) me origjinë kryesisht nga gjaku periferik, pas mobilizimit të tyre nga PKK, autologe apo alogjenike, është një nga trajtimet që ka siguruar rritjen e jetëgjatësisë së pacientevë me sëmundje tumorale malinje. Por HSCT përdoret dhe në trajtimin e patologjive jo malinje hematologjike.

**Arritjet:** Për herë të parë, në Spitalin Amerikan, synohet të realizohet Transplanti Autolog për sëmundjet malinje hematologjike, një realitet i prekshëm tashmë për pacientët shqiptarë.

#### **PO 45 Paqëndrueshmëria gjenomike dhe evolucioni somatik qelizor darvinian - Evolucioni klonal në malignancies hematologjike dhe implikime terapeutike**

*Lako S.*

Zhvillimi evolucionar i kancerit sipas modelit të Evolucionit dhe Selektimit Natyror të Darvinit, u propozua për herë të parë nga Nowell në 1976.

Kanceri është sëmundje gjenetike, epigjenetike, një linjë qelizore dhe është subjekt i të njëjtave rregulla të Selektimit Natyral si çdo qenie tjetër e gjallë.

Kanceri fillon me ndryshime gjenetike dhe epigjenetike jo letale në një qelizë të vetme somatike të organizmit, të shoqëruara me ndryshime fenotipike (struktorore dhe funksionale) që i sigurojnë kësaj qelize avantazh në mbijetesë, zënies hapësira dhe riprodhim, kundrejt qelizave të tjera normale të organizmit.

Pasojë e këtyre ndryshimeve do të jetë prishja e ekuilibrave në proliferimin, diferencimin dhe vdekjen qelizore, formimi i një kloni qelizor i përbërë nga shumë subklone (nënklone) qelizash tumorale me ndryshime gjenetike dhe epigjenetike, për rrjedhojë dhe fenotipike midis tyre, që është përgjegjës për heterogjenecitetin brënda një kanceri dhe midis tumoreve malinj të të njëjtit tip.

